


STUDIMI MBI NEVOJAT EMERGJENTE DHE NDIKIMIN SOCIO-EKONOMIK TË COVID-19 NË QEVERISJEN LOKALE NË KOSOVË



Asociacioni i Komunave të Kosovës
Association of Kosovo Municipalities
Asocijacija Kosovskih Opština



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

“Studim mbi Nevojat Emergjente dhe Ndikimin Socio-ekonomik të COVID-19 në Qeverisjen Lokale në Kosovë”

*Raporti mbi Nevojat Emergjente dhe Ndikimin Social-Ekonomik të COVID-19 -
Pyetësi Online dhe Grupet e Fokusuara të Diskutimit*

Ky studim është financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SDC).

Ky raport është draftuar nga UBO Consulting, në emër të Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK).



Bajram Curri No.5, Arbëria
Prishtina, 10000, Kosovo
E-mail: info@uboconsulting.com
Web: www.uboconsulting.com

Përmbajtja

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	6
1.1. Të gjeturat kryesore	6
2. HYRJE	8
2.1. Informata të përgjithshme në lidhje me pandeminë COVID-19	9
Situata me COVID-19 në Kosovë	9
Pasojat e COVID-19	10
Paketa Emergjente Fiskale	10
2.2. Aktivitetet e Asociacionit të Komunave të Kosovës në lidhje me COVID-19	11
3. METODOLOGJIA E STUDIMIT	14
4. REZULTATET E STUDIMIT	17
4.1. Rezultatet nga Pyetësi i Kryetarëve të Komunave	17
4.1.1. Vështirësitë me të cilat u përballën komunat që nga përhapja e pandemisë COVID-19 .	17
4.1.2. Masat e ndërmarra nga komunat për të menaxhuar situatën e krijuar nga pandemia COVID-19.....	18
4.1.3. Bashkëpunimi me institucionet e nivelit qendror, që nga përhapja e pandemisë COVID-19 në komuna.....	21
4.1.4. Bashkëpunimi me Asociacionin e Komunave të Kosovës, që nga përhapja e pandemisë COVID-19 në komuna.....	23
4.1.5. Nevojat emergjente të komunave për të menaxhuar dhe kapërcyer situatën e shkaktuar nga pandemia COVID-19.....	24
4.2. Rezultatet nga Anketa me Drejtorë	26
4.2.1. Vështirësitë me të cilat u përballën drejtoritë që nga përhapja e pandemisë COVID-19	26
4.2.2. Masat e ndërmarra nga drejtoritë për të menaxhuar situatën e krijuar nga pandemia COVID-19.....	30
4.2.3. Bashkëpunimi me institucionet e nivelit qendror, që nga përhapja e pandemisë COVID-19 në komuna.....	32
4.2.4. Bashkëpunimi me Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK), që nga përhapja e pandemisë COVID-19 në komuna	35
4.2.5. Nevojat emergjente të drejtorive për menaxhimin dhe tejkalimin e situatës së shkaktuar nga pandemia COVID-19.....	36
4.3. Zhvillimi i kapaciteteve/nevojat për trajnime për përfaqësuesit komunal	39
4.4. Ndikimi i pandemisë COVID-19 në të ardhurat vetanake komunale	40
5. PËRFUNDIMET	42

Lista e Figurave

Figura 1. Niveli i përgatitjes në trajtimin e një situatë të tillë pandemike.....	18
Figura 2. Rialokimi i Buxhetit Komunal në luftimin e pandemisë COVID-19.....	20
Figura 3. Përgatitja e Pakos Emergjente Fiskale për të ndihmuar bizneset private dhe kategoritë e tjera në nevojë	21
Figura 4. Bashkëpunimi me institucionet e nivelit qendror, që nga përhapja e pandemisë COVID-19 në komuna.....	21
Figura 5. Vlerësimi i bashkëpunimit me institucionet e nivelit qendror / ministritë e linjës, që nga përhapja e pandemisë COVID-19 në komuna.....	22
Figura 6. Bashkëpunimi me Asociacionin e Komunave të Kosovës, që nga përhapja e pandemisë COVID-19 në komuna	23
Figura 7. Vlerësimi i bashkëpunimit me Asociacionin e Komunave të Kosovës, që nga përhapja e pandemisë COVID-19 në komuna.....	24
Figura 8. Niveli i përgatitjes në trajtimin e një situatë të tillë pandemike.....	28
Figura 9. Bashkëpunimi me institucionet e nivelit qendror, që nga përhapja e pandemisë COVID-19 në komuna.....	32
Figura 10. Vlerësimi i bashkëpunimit me institucionet e nivelit qendror / ministritë e linjës, që nga përhapja e pandemisë COVID-19 në komuna.....	34
Figura 11. Bashkëpunimi me Asociacionin e Komunave të Kosovës, që nga përhapja e pandemisë COVID-19 në komuna	35
Figura 12. Vlerësimi i bashkëpunimit me Asociacionin e Komunave të Kosovës, që nga përhapja e pandemisë COVID-19 në komuna.....	36
Figura 13. Përqindja e përfaqësuesve të komunave që kanë nevojë për ngritje të kapaciteteve / trajnime	39
Figura 14. Mënyra e preferuar e pjesëmarrjes në trajnime.....	40

Lista e Shkurtesave

AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
ARBK	Agjencia e Regjistrimit të Biznesit në Kosovë
BB	Banka Botërore
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BE	Bashkimi Evropian
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
IFN	Institucionet Financiare Ndërkombëtare
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MEPTINIS	Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrjes dhe Investimeve Strategjike
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MFT	Ministria e Financave dhe Transfereve
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetit
SDC	Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Gjatë periudhës Maj-Korrik 2020, UBO Consulting, në emër të Asociacionit të Komunave të Kosovës (referuar tutje si AKK), kreu një studim mbi "Nevojat emergjente dhe ndikimin socio-ekonomik të COVID-19 në pushtetin lokal në Kosovë". Ky studim synonte identifikimin e vështirësive të hasura nga komunat gjatë përhapjes së pandemisë COVID-19, masave të marra nga këto të fundit për të menaxhuar këtë situatë, bashkëpunimin me nivelin qendror dhe AKK-në, si dhe nevojat emergjente të komunave për të tje kaluar pasojat socio-ekonomike nga përhapja e pandemisë COVID-19. Studimi u mbështet nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SDC).

Për qëllimin e këtij studimi, janë realizuar gjithsej 255 intervista gjysmë të strukturuar dhe tetë (8) grupe të fokusuar të diskutimit. Përderisa intervistat kanë përfshirë si kryetarët poashtu dhe drejtorët komunal, grupet e fokusuar të diskutimeve u mbajtën vetëm me drejtorët komunalë. Studimi përfshiu 34 komunat e Kosovës, anëtare të AKK-së.

Seksioni vijues paraqet gjetjet kryesore që rrjedhin nga intervistat dhe seancat e grupeve të fokusuar të diskutimeve, me grupet e lartpërmendura të përfaqësuesve komunalë.

1.1. Të gjeturat kryesore

- Buxheti i kufizuar dhe mungesa e masave mbrojtëse siç janë maskat për fytyrë, dorezat dhe dezinfektuesit e duarve, u përmendën si vështirësitë kryesore me të cilat u ballafaquen shumica e komunave që nga përhapja e pandemisë COVID-19. Vështirësi të tjera përfshinin mungesën e personelit mjekësor, teknologjinë për realizimin e mësimit online, ndalimin e zhvillimit të aktiviteteve të caktuara ekonomike, etj.
- Shumica e përfaqësuesve të komunave (57%) deklaruan se ishin të përgatitur deri në një masë për ballafaqimin e një situatë të tillë pandemike.
- Në përgjithësi, masat e marra nga drejtoritë komunale për të menaxhuar situatën e krijuar nga pandemia COVID-19 përfshinin dezinfektimin e objekteve komunale dhe hapësirave publike, pajisjen e personelit me masa mbrojtëse, uljen e numrit të stafit dhe punën me rotacion. Gjithashtu, në të gjitha komunat u krijua Shtabi Lokal Emergjent.
- Masat e tjera të marra nga drejtoritë specifike ishin rialokimi i buxhetit, hartimi i pakos së rimëkëmbjes ekonomike, ofrimi i informacionit mbi vendimet e Qeverisë për bizneset dhe komunitetin lokal, shpërndarja e pakove ushqimore dhe higjienës për familjet në nevojë, etj.
- Shumica e përfaqësuesve të komunave (71%) deklaruan se kishin bashkëpunuar me të gjitha ministrinë e linjës / institucionet e nivelit qendror gjatë përhapjes së pandemisë COVID-19 dhe 55% e tyre ishin "shumë / disi të kënaqur" me këtë bashkëpunim.
- Më shumë se gjysma e drejtorëve komunalë (57%) në këtë studim kanë bashkëpunuar me AKK-në, ndërsa shumica e tyre (82%) ishin "disi / shumë të kënaqur" me këtë bashkëpunim. Bashkëpunimi midis kryetarëve të komunave dhe AKK-së ishte edhe më i lartë (66%).
- Nevojat emergjente ndryshuan sipas specifikave të drejtorive komunale. Sidoqoftë, dy nevoja të përbashkëta emergjente për shumicën e drejtorive komunale ishin nevoja për dizajnimin e pakos së rimëkëmbjes ekonomike dhe ndarjen e fondit emergjent.

- Nevojat e tjera emergjente përfshinin: mungesën e personelit shëndetësor, mungesën e mjeteve teknologjike për realizimin e mësimit nga distanca, udhëzimet e sakta për dezinfektimin e hapësirave publike, rrugëve dhe zonave urbane, etj.
- Sigurimi i masave mbrojtëse, fondet mbështetëse dhe subvencionet për biznese të ndryshme u përmendën si masa që mund të merren gjithashtu nga organizatat e donatorëve, institucionet huadhënëse dhe shoqatat e ndryshme, të cilat do të ndihmonin në menaxhimin dhe tejkalimin e situatës aktuale në komuna.
- Së fundmi, sipas shumicës së drejtorëve komunalë (70%), zyrtarët e tyre kanë nevojë për ndërtim të kapaciteteve / trajnime për tema të ndryshme si menaxhimi i situatave emergjente, siç ishte pandemia COVID-19, planifikimi i buxhetit në situata emergjente, trajnimi për realizimin e shërbimeve online dhe trajnimi i prokurimit, në të cilat shumica e tyre (78%) preferuan të merrnin pjesë përmes pjesëmarrjes fizike, krahasuar me pjesëmarrjen përmes platformave online.

2. HYRJE

Në maj të vitit 2020, UBO Consulting u kontraktua nga AKK për të kryer një studim mbi nevojat emergjente dhe ndikimin socio-ekonomik të COVID-19 në pushtetin lokal në Kosovë. Qëllimi kryesor i studimit ishte të kuptohej më thellësisht ndikimi socio-ekonomik i COVID-19 në nivelin lokal, si dhe t'u ofrohej një mundësi përfaqësuesve të komunave të identifikojnë dhe shprehin nevojat e tyre emergjente, të cilat më vonë do t'u prezantoheshin të gjitha institucioneve përkatëse dhe palëve të interesit. Ky studim u mbështet nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SDC).

Për shkak të përhapjes së shpejtë të virusit, ndryshimeve të shpeshta në masat kufizuese dhe limitimeve të buxhetit, komunat e Kosovës, duke qenë në vijën e parë të ofrimit të shërbimeve për qytetarët e tyre dhe menaxhimin e situatës me COVID-19, u përballën me sfida dhe vështirësi të shumta. Si rrjedhojë, AKK u ballafaqua me kërkesa të panumërta nga këto të fundit. Duke qenë përgjegjës për t'i adresuar ato kërkesa tek institucionet e nivelit qendror dhe t'i ndihmojë komunat gjatë kësaj periudhe, AKK inicioi idenë e realizimit të një studimi mbi nevojat emergjente dhe ndikimin socio-ekonomik të COVID-19 në pushtetin lokal në Kosovë. Ndër të tjera, rezultatet e këtij studimi do t'iu prezantohen të gjitha institucioneve përkatëse dhe palëve të interesit, si dhe do të shërbejnë si një udhëzues për hartimin e programeve, aktiviteteve ose formave të intervernimit, me qëllim të mbështetjes së komunave të Kosovës në përballje me pandeminë COVID-19.

Në këtë rast, agjensioni UBO Consulting ndihmoi AKK-në me asistencë teknike në hartimin, zhvillimin dhe administrimin e studimit. Përkatësisht, detyrat kryesore të agjencisë përfshinin:

- Përgatitjen e instrumenteve të hulumtimit (pyetësorët e kryetarëve dhe drejtorëve)
- Propozimin e metodave dhe procedurave të mbledhjes së të dhënave
- Realizimin e intervistave gjysmë të strukturuar me kryetarët dhe drejtorët komunalë
- Realizimin e diskutimeve me drejtoritë komunale përmes grupeve të fokusuara të diskutimit
- Realizimin e një analize të thelluar të rezultateve nga intervistat dhe diskutimet
- Hartimin e një raporti të përgjithshëm me të gjeturat e studimit
- Realizimin e një prezantimi me të gjeturat kyçe të studimit

Ky dokument është hartuar me qëllim të prezentimit të rezultateve të nxjerra nga realizimi i 255 intervistave gjysmë të strukturuar dhe tetë (8) grupeve të fokusuara të diskutimit. Për më tepër, dokumenti përfshin përshkrimin e metodologjisë, instrumentin e mbledhjes së të dhënave dhe procesin e rekrutimit. Përfundimet nga rezultatet e këtij studimi janë gjithashtu pjesë e këtij raporti.

2.1. Informata të përgjithshme në lidhje me pandeminë COVID-19

Koronavirus 2019 (COVID-19) është një sëmundje infektive e shkaktuar nga sindromi i rëndë akut i frymëmarrjes koronavirus 2 (SARS-CoV-2). Në vitin 2019, ajo u identifikua si shkaktare e një shpërthimi të sëmundjes e cila filloi në Kinë. Në Mars të vitit 2020, Organizata Botërore e Shëndetit (OBSh) e shpalli virusin COVID-19, një pandemi.¹ Tani, kjo pandemi është e përhapur në të gjithë globin dhe deri më sot ka 11,790,944 raste të konfirmuara dhe 541,895 vdekje.² Sipas statistikave të fundit, Shtetet e Bashkuara renditen në vendin e parë me numrin më të madh të rasteve të konfirmuara - 1.8 milion raste të konfirmuara, të ndjekura nga Brazili dhe India.³

Situata me COVID-19 në Kosovë

Dy rastet e para të konfirmuara në Kosovë janë regjistruar me datën 13 Mars në dy komuna të ndryshme, Viti dhe Klinë. Kjo ngjarje u pasua nga një vendim i menjëhershëm i Qeverisë së Kosovës për të karantinuar dhe bllokuar hyrjet-daljet e këtyre dy qyteteve. ⁴ Që nga 11 Marsi, shkollat janë mbyllur, linjat e transportit ajror dhe rrugor janë pezulluar, aktivitetet publike dhe jopublike janë lejuar vetëm pa praninë e publikut, si dhe të gjitha restoranteve, klubeve të natës, palestrave, pishinave etj u është ndaluar veprimtaria e tyre.⁵ Për shkak të rritjes së numrit të rasteve të konfirmuara me COVID-19, më 15 Mars, Qeveria ka shpallur gjendje të jashtëzakonshme të shëndetit publik,⁶ ndërsa me datën 15 Prill,⁷ me vendim të Qeverisë, kufizimet u forcuan dhe intensifikuan edhe më tutje. Masat kufizuese të vendosura nga Qeveria e Kosovës si përgjigje ndaj pandemisë COVID-19 u ndryshuan edhe më tej, sipas fazave të përshkruara më poshtë:

Faza 1

Duke marrë parasysh që numri i rasteve të konfirmuara kishte arritur kulmin dhe si rrjedhojë kurba e të infektuarve filloi të ulej, Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë ka lehtësuar kufizimet, duke filluar me fazën 1 në 4 Maj, 2020. Në këtë fazë, qytetarët u lejuan të lëvizin lirshëm për tre orë në ditë (1.5 orë dhe 1.5 orë pasdite) – orari varionte duke u bazuar në numrin e parafundit të numrit personal të qytetarëve. Për më tepër, kompanitë që u lejuan të fillojnë punën e tyre në mënyre normale ishin kompanitë e ndërtimit, kompanitë që bëjnë tregti automjetesh (pjesërisht), kompanitë e shitjes me pakicë (pjesërisht), kompanitë që ofrojnë shërbime për riparim, dhe kompanitë e konsulencës.

¹ Klinika Mayo (2020). Sëmundja e Koronavirusit 2019 (COVID-19)—Simptomat dhe shkaqet. Marrë më: 14 Prill 2020. url.: https://en.wikipedia.org/wiki/Coronavirus_disease_2019

² Worldometer (2020). Rastet e Koronavirusit në Botë. Marrë më: 06 Korrik, 2020. url.: <https://www.worldometers.info/coronavirus/>

³ Koronavirus. OBSh.int. (2020). Marrë më: 4 Qershor 2020, from <https://www.who.int/emergencies/diseases/novel-coronavirus-2019>.

⁴ Wikipedia (2020). 2020 Pandemia COVID-19 në Kosovë. Marrë më: 22 Prill,2020. url.: https://en.wikipedia.org/wiki/2020_coronavirus_pandemic_in_Kosovo

⁵ Qeveria e Kosovës (2020). Vendimi Nr. 01/07. Marrë më: 22 Prill, 2020. url.: <https://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2020/03/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-7-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs-2020.pdf>

⁶ Qeveria e Kosovës (2020). Vendimi Nr. 01/11. Marrë më 22 Prill, 2020. url.: <https://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2020/03/Vendimi-nr.01-11.pdf>

⁷ Ministria e Shëndetësisë (2020). Vendimi No./2020. Marrë më 22 Prill, 2020. url.: <https://msh.rks-gov.net/ep-content/uploads/2020/04/Vendim.pdf?fbclid=IêAR35jlkDÈH6kpNrICèBfA78TÈpNdK9LeKRdsuTegP9txN66cLHlio2LvShI>

Faza 2

Faza e dytë filloi më 18 Maj 2020. Në këtë fazë, qytetarëve u lejohej lëvizja e lirë për katër orë në ditë (2 orë në mëngjes dhe 2 orë në pasdite) - orari i qytetarëve varej nga numri i parafundit i numrit personal të tyre. Kompanitë që lejohehin të operonin plotësisht ishin kompanitë e shitjes me pakicë, dentistët dhe fizioterapeutët, parukierët dhe sallonet e bukurisë, si dhe tregjet e gjelbërta. Për më tepër, restorantet dhe baret u lejuan të ofronin shërbimet e tyre vetëm përmes metodës- merr me vete. Gjatë kësaj kohe, gjithashtu, u lejua transporti hekurudhor dhe ai urban. Dhe së fundi, u hapën muzetë, galeritë dhe qendrat e thirrjeve.

Faza 3

Faza përfundimtare filloi më 28 Maj 2020, ku kufizimet në lëvizjen e qytetarëve u larguan pothuajse plotësisht; lëvizjet ishin të kufizuara vetëm nga ora 21:00 deri në orën 05:00. Nga 1 Qershori i vitit 2020, taksive iu mundësuan të punojnë, transporti urban dhe interurban filluan zyrtarisht funksionimin e tyre të plotë, restorantet dhe baret filluan të funksionojnë normalisht, u hapën kinematë dhe teatri dhe u lejuan të zhvillohen disa aktivitete sportive në salla. Sa i përket arsimit, provimet e rëndësishme në arsimin e lartë dhe provimi i arritjeve u lejua të mbaheshin fizikisht nga studentët.⁸

Fatkeqësisht, numri i rasteve të konfirmuara është rritur ndjeshëm me heqjen e plotë të kufizimeve të Qeverisë, më 1 qershor 2020. Si rezultat, deri më tani, Kosova regjistron një numër prej 3,508 raste të konfirmuara dhe 75 vdekje.⁹

Pasojat e COVID-19

Fokusi kryesor i Qeverisë së Kosovës ishte të ndalojë intensitetin e përhapjes së virusit; megjithatë, këto masa patën efekte anësore kur në aspektin socio-ekonomik të vendit. Edhe pse pasojat janë të pranishme në çdo vend që është prekur nga COVID-19, ato janë më të theksuara në vendet në zhvillim siç është Kosova. Përhapja e COVID-19 dhe masat e nevojshme të kontrollit kanë vënë investimet, konsumin privat, por edhe eksportet dhe ndihmat nga diaspora, nën një tendosje të jashtëzakonshme. Për Kosovën, Banka Botërore raporton që ekonomia do të ulet me 4,5 përqind në vitin 2020, e ndjekur nga një rikthim në 2021.¹⁰

Paketa Emergjente Fiskale

Për shkak të pasojave që rezultuan nga masat e marra për të parandaluar përhapjen e COVID-19, Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Transfereve ka hartuar Pakon Emergjente Fiskale. Pakoja Emergjente Fiskale kishte vlerën prej 179.6 milion €. Kjo pako përfshiu 15 masa që prekën pothuajse çdo individ dhe biznes që përballëj me vështirësitë e krijuara nga COVID-19, ku hynë qytetarët me skema sociale dhe pensionerët, punonjësit që kanë qenë në rrezik

⁸ Shfuqizimi i vendimeve të datës 31.03.2020 dhe vendimet e reja të Ministrisë së Shëndetësisë rreth Covid-19 – Ministria e Shëndetësisë. Msh.rks-gov.net. (2020). Retrieved 4 June 2020, from <https://msh.rks-gov.net/vendimet-e-reja-te-ministrise-se-shendetesise-rreth-covid-19/>

⁹ Ministria e Shëndetësisë (2020). Statistikat Ditore të Koronavirusit. Marrë më 22 Prill, 2020. url.:<https://kosova.health/>

¹⁰ Ekonomia e Kosovës parashikohet të kontraktohet me 4.5 përqind në vitin 2020 për shkak të COVID-19. Worldbank.org (2020). Marrë më: 19 Qershor, 2020, from <https://www.worldbank.org/en/news/press-release/2020/04/29/kosovo-economy-projected-to-contract-by-45-percent-in-2020-due-to-covid-19>

të lartë si stafi i policisë, infermierët, mjekët, zjarrfikësit dhe punonjësit që punonin në supermarkete, farmacitë dhe furrat e bukës. Kompanitë të cilat u detyruan të ndërpresin veprimtarinë e tyre për shkak të COVID-19 dhe kishin nevojë për ndihmë financiare, u mbeshtetën përmes subvencionimit të qirasë dhe eksporteve. Normat e interesit të kredisë së tyre u shtynë për tre muaj si dhe u ndihmuan me pagat e punonjësve për muajin Prill dhe Maj - kjo pako pagoi punonjësit që kishin kontratë pune të vlefshme si dhe punonjësit që u larguan nga puna për shkak të rrethanave. Qytetarët e papunë ishin gjithashtu pjesë e përfitimeve të kësaj pakoje. Për më tepër, Pako Emergjente Fiskale përfshiu grante për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.¹¹

Pakoja Emergjente Fiskale është krijuar me qëllim të minimizimit të dëmeve që janë shkaktuar nga COVID-19, por jo edhe kompensimit të të gjitha pasojave nga pandemia. Si rrjedhojë, një pako tjetër është duke u hartuar. Pako e Rimëkëmbjes Ekonomike është një pako e cila është planifikuar të dizajnohet për kompanitë dhe qytetarët e Kosovës në mënyrë që t'u ofrohet një shtytje shtesë financiare që do t'i ndihmojë ata të tejkalojnë këtë situatë.

2.2. Aktivitetet e Asociacionit të Komunave të Kosovës në lidhje me COVID-19

Komunat e Kosovës janë aktivizuar dhe kanë punuar jashtë limiteve të tyre për të marrë vendime më të mira për qytetarët në lidhje me luftën kundër përhapjes së pandemisë. Ata janë përballur me sfida dhe probleme të ndryshme për shkak të pandemisë. Meqenëse, pothuajse të gjitha vendimet dhe masat u morën nga institucionet e nivelit qendror, bashkëpunimi i autoriteteve të nivelit lokal me Qeverinë e Kosovës gjatë kësaj periudhe ishte shumë i rëndësishëm. Në këtë kontekst, AKK, duke qenë ndërmjetësuesi kryesor i këtij bashkëpunimi kishte një rol vendimtar. Duke pasur parasysh rolin e tij, si dhe duke u ballafaquar me kërkesa të panumërta nga komunat, AKK ishte shumë aktive në aspekt të adresimit të kërkesave të komunave drejt institucioneve të nivelit qendror, ku në të njëjtën kohë, duke informuar komunat për të gjitha vendimet dhe masat e marra nga Qeveria, si reagim ndaj COVID-19. Në vijim janë të prezentuara disa prej aktiviteteve të kryera nga AKK:

- Më 11 Mars, para rastit të parë të konfirmuar në Kosovë, AKK kërkoi nga Qeveria të furnizonte komunat me të gjitha masat e nevojshme për mbrojtje nga koronavirusi, siç janë dorezat, maskat dhe dezinfektuesit; veçanërisht për punonjësit e shëndetësisë të cilët ishin gjithmonë në vijën e parë të frontit.
- Kolegjiumi për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i AKK-së, më 17 Mars 2020, nën udhëheqjen e Kryetarit Z. Bujar Gashi, mbajti takimin e radhës në lidhje me situatën e krijuar në Kosovë pas rasteve të para të konfirmuara me COVID-19.
- Më 18 Mars, AKK i drejtohet Qeverisë dhe Ministrisë së Financave për lëshimin e lejes për rialokim të mjeteve financiare që mund të ndihmojnë qytetarët kosovarë të luftojnë COVID-19; ky rialokim i buxhetit u aprovua nga Ministria e Financave dy ditë më vonë.
- Më 20 Mars, AKK iu drejtua Qeverisë me një kërkesë tjetër; të pezullojë shërbimet e restoranteve që praktikonin metodën- merr me vete, pasi që mbledhja e qytetarëve në këta operatorë mund të shkaktojë përhapjen e COVID-19.

¹¹ Mf.rks-gov.net. (2020). Marrë më 5 Qershor, 2020, from <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/CF860B38-765C-41B3-87D0-6E38AD371584.pdf>.

- Më 21 Mars, kryetarët e komunave kanë bërë një thirrje kolektive që qytetarët të qëndrojnë në shtëpitë e tyre dhe të respektojnë masat e institucioneve të tyre për të luftuar përhapjen e pandemisë.
- Më 22 Mars, AKK publikoi "Planin Kombëtar të Reagimit" i cili përfshiu përgjegjësitë për komunat dhe kryetarët e komunave.
- Më 23 Mars, AKK ka këmbëngulur të lehtësojë procedurat e prokurimit publik në situata emergjente.
- Kërkesa e AKK-së për pezullimin e veprimtarive ligjore të asamblesë së komunave në lidhje me aspektet financiare për luftimin e COVID-19 u aprovua më datën 24 mars.
- Më 27 Mars, AKK kërkoi të ndryshojë orarin e lëvizjes së lirë. Së pari, kufizimet ishin nga 10: 00-16: 00 dhe nga 20: 00-06: 00, por për shkak të kohës tejet të kufizuar për lëvizje të lirë, AKK ka shtruar kërkesën për ndryshim të orarit dhe vendosjen e kufizimeve nga 18: 00-06 : 00. Kjo kërkesë u miratua më 28 Mars.
- Më 30 Mars, kolegji i Buxhetit dhe Financës i AKK-së kërkoi shtyrjen e normave të interesit të kredive dhe gjobave për tatimpaguesit. Kërkesa u miratua më 1 Prill.
- Pas kërkesës së Kolegjit për Buxhet dhe Financa të AKK-së drejtuar Ministrisë së Financave dhe Transfereve, më 1 Prill kjo e fundit aprovoi ndalimin e kamatës dhe gjobitjeve për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës për vonesat në pagimin e taksës së pronës deri në tejkalimin e pandemisë.
- Më 31 Mars, AKK ka kërkuar të përfshijë inspektorët e komunave në Pakon Emergjente Fiskale.
- AKK në mënyrë konsistente, bashkëpunoi me Ministrinë e Shëndetësisë për koordinimin e orarit mbi lëvizjen e lirë të qytetarëve të Kosovës.
- Më 14 Prill, AKK ka reaguar në lidhje me vendimin e masave për të filluar më 15 Prill, pasi që ato u morën pa konsultim paraprak me autoritetet lokale.
- Për më tepër, AKK ka kërkuar lëvizje të lirë, pa asnjë kufizim, për fermerët nga 14 Prilli.
- Më 15 Prill, AKK ka kërkuar të lejojë investimet në infrastrukturë dhe shërbimet e mirëmbajtjes në komuna. Kjo kërkesë u aprovua më 18 Prill.
- Më 22 Prill, përfaqësuesit e AKK-së janë takuar me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për të diskutuar më tej rreth masave që duhet të merren për luftimin e COVID-19.
- Komunave u ishte ndaluar të vazhdojnë aktivitetet e prokurimit për investime kapitale; Prandaj, AKK ka reaguar kundër këtij vendimi më 23 prill. Pas reagimit të AKK-së, më 27 Prill, komunat mund të publikonin tenderët pasi që aktivitetet e prokurimit nuk vazhdonin të mbaheshin më gjatë nën pezullim.
- Më 28 Prill, AKK kërkoi mundësinë që të mos aplikohen vonesat e normave të interesit ose gjobave të papaguara të taksave për vitin 2020.
- Më 29 Prill, AKK ka organizuar një takim me Grupin Punues të Zyrtarëve Komunal në lidhje me menaxhimin e mbeturinave përmes platformave në internet.
- Me propozimin e AKK-së, më 5 Maj, u vendos që të mos shqiptohen gjoba për taksat e papaguara të pronave për vitin 2020.
- Gjatë muajit Maj dhe Qershor, drejtori i AKK-së ka vizituar komuna si Suhareka, Istogu, Skenderaj, Ferizaj, Peja, Deçani, Mamusha, Prizreni, Obiliqi dhe Vitia. Drejtori i AKK-së ka

diskutuar me secilin kryetar të këtyre komunave për situatën aktuale me COVID-19 dhe planet e komunave për parandalimin e mëtejshëm të COVID-19.

- Më 22 Maj, AKK ka kërkuar nga Ministria e Bujqësisë të rivlerësojë listën e refuzimit të fermerëve të cilët ishin përjashtuar nga ndihmat e mundshme financiare, pasi që disa prej tyre nuk ishin në dijeni të disa procedurave që duhej të ndiqeshin.
- Më 23 Maj, AKK ka kërkuar të shkurtohet periudha e fazës 2 të masave për luftimin e COVID-19.
- Më 26 Maj, me kërkesën e AKM, gjobat në lidhje me vonesat e regjistrimit civil u pezulluan.
- Më 2 Qershor, AKK ka reaguar në lidhje me vendimin për mos hapjen e kopshteve më 1 Qershor ashtu siç ishte planifikuar, si dhe për mungesën e koordinimit ndërinstytucional midis Qeverisë dhe AKK-së për këtë çështje.
- Drejtori Ekzekutiv i AKK-së, Z. Sazan Ibrahim i vizitoi komunën e Vitisë më 2 Qershor. Z. Ibrahim informoi kryetarin Haliti për aktivitetet dhe veprimet e AKK-së në lidhje me mbështetjen e komunave përmes lehtësimit të koordinimit me institucionet e nivelit qendror.
- Në një takim ndërinstytucional, të mbajtur më 8 Qershor, Ministri i Shëndetësisë, Z. Armend Zemaj dhe Këshilli i Kryetarëve të Komunave u takuan në një takim për të diskutuar situatën aktuale me Pandeminë Covid-19. Gjatë fjalimit të tij, Nënkryetari i AKK-së, Z. Xhafer Gashi theksoi disponueshmërinë e AKK-së për të mbështetur dhe ndihmuar në luftën kundër përhapjes së COVID-19.
- Më 10 Qershor, kryetarët e komunave dhe Qeveria e Kosovës diskutuan procesin e rishikimit të buxhetit. Në këtë takim u debatua në lidhje me rishikimin e buxhetit komunal gjatë procesit të rishikimit të buxhetit, situatës ekonomike dhe buxhetore si rezultat i Pakos Emergjente Fiskale dhe Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike nga pandemia COVID-19.
- MASHT, MSH, IKSHPK në konsultim me AKK-në, më 13 Qershor, vendosën që mësimi plotësues për testin e maturës së shkollës së mesme të mbahet në mënyrë virtuale.
- Më 30 Qershor, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë u takua me Kolegjiun e Inspektionit të AKK-së. Ata diskutuan në lidhje me masat për të parandaluar përhapjen e mëtejshme të COVID -19 si dhe vendosjen e gjobave të parashikuara për qytetarët dhe bizneset që nuk respektojnë udhëzimet e institucioneve përkatëse në periudhat e pandemisë. Në fund të takimit, pjesëmarrësit ranë dakord për konkludimet e mëposhtme:
 - a. Themelimin e një Task Force për koordinim midis nivelit qendror dhe atij lokal në fushën e inspektimeve sanitare, ku pritet të bëhet identifikimi dhe zgjidhja e problemeve.
 - b. Rritjen e numrit të inspektorëve sanitar në mënyrë që të monitorohen vazhdimisht bizneset gjatë periudhës së kufizimeve pandemike.
 - c. Ofrimi i ndihmës së Policisë në zbatimin e masave të parashikuara përmes manualit të Ministrisë së Shëndetësisë.
 - d. Ofrimi i bashkëpunimit më të madh ndërmjet Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës me Komunitat.
- Më 1 Korrik, me kërkesë të Asociacionit të Komunave të Kosovës, Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) i ka lejuar komunitat dhe të gjitha autoritetet kontraktuese që të përfundojnë dhe ndryshojnë sipas nevojës Planet e Prokurimit për vitin 2020.

3. METODOLOGJIA E STUDIMIT

Për qëllime të hulumtimit, UBO Consulting përdori metodën kaulitative të hulumtimit, përkatësisht intervistat gjysmë të strukturuar dhe grupet e fokusuar të diskutimit. Kjo metodë e hulumtimit zakonisht përdoret për të grumbulluar informacion të thelluar nga përvojat, qëndrimet dhe perceptimet personale komplekse të pjesëmarrësve.

UBO Consulting zhvilloi 255 intervista gjysmë të strukturuar me përfaqësuesit e komunave nga të gjitha 34 komunat e Kosovës, anëtare të AKK-së, dhe gjithsej tetë (8) grupe të fokusuar të diskutimit me drejtoritë më të prekura nga komunat e lartpërmendura. Intervistimi gjysmë i strukturuar rezultoi si më i favorshëm për faktin se u mundësoi pjesëmarrësve të shprehin në mënyrë të plotë përvojën dhe shqetësimet e tyre rreth ndikimit socio-ekonomik të COVID-19 në komunat e tyre.

Duke marrë parasysh masat e Qeverisë si reagim ndaj COVID-19, studimi u realizua duke përdorur **PLATFORMAT ONLINE**. Përkatësisht, intervistat gjysmë të strukturuar janë realizuar përmes një pyetësoi me bazë në internet, i cili u nda në 5 tema, me gjithsej 18-21 pyetje. Pjesa dërrmuese e pyetjeve ishin të hapura, ku pjesëmarrësi mund të shprehte informata të hollësishme lidhur me çështjet që trajtoheshin nga pyetësoi. Pyetësoi u nda në temat e mëposhtme:

1. Vështirësitë me të cilat përballen komunat / drejtoritë që nga përhapja e pandemisë COVID-19
2. Masat e marra nga komunat / drejtoritë për të menaxhuar situatën e krijuar nga pandemia COVID-19
3. Bashkëpunimi mes komunave/ drejtorive me institucionet e nivelit qendror, që nga përhapja e pandemisë COVID-19
4. Bashkëpunimi mes komunave/ drejtorive me Asociacionin e Komunave të Kosovës, që nga përhapja e pandemisë COVID-19
5. Nevojat emergjente të komunave / drejtorive për të menaxhuar dhe tejkaluar situatën e shkaktuar nga pandemia COVID-19

Për më shumë, intervistat gjysmë të strukturuar fillimisht u finalizuan në gjuhën shqipe, e më pas ato u përkthyen dhe u përshtatën në gjuhën angleze dhe serbe.

Pas identifikimit të kontakteve përmes listës së siguruar nga AKK, pjesëmarrësit u rekrutuan përmes postës elektronike, ku më pas u telefonuan në mënyrë direkte. E-maili rekrutues përmbante qëllimin e studimit, linkun e pyetësoi online, dhe informacionin kontaktues elektronik dhe telefonik të hulumtuesit. Në mesin e 300 përfaqësuesve komunalë që u kontaktuan, 255 prej tyre pranuan të jenë pjesë e hulumtimit duke u përgjigjur në pyetësoin online; duke prodhuar kështu një shkallë prej 85% të pjesëmarrjes në këtë studim.

Përfaqësuesit Komunalë	Numri i Intervistave të realizuara
Kryetarët	29
Drejtoria e Buxhetit dhe Financave	32
Drejtoria e Shëndetit dhe Mirëqenies Sociale	27
Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik	29
Drejtoria e Edukimit	28
Drejtoria e Bujqësisë	28
Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	24
Drejtoria e Administratës	26
Drejtoria e Shërbimeve Publike	32
TOTAL	255

Për më tepër, për fazën e dytë të këtij studimi, UBO Consulting gjithashtu realizoi tetë grupe të fokusuar në diskutim, të kategorizuara si më poshtë:

- Një (1) grup i fokusuar në diskutim me Drejtorët e Buxhetit dhe Financave
- Një (1) grup i fokusuar në diskutim me Drejtorët e Shëndetit dhe Mirëqenies Sociale
- Një (1) grup i fokusuar në diskutim me Drejtorët e Zhvillimit Ekonomik
- Një (1) grup i fokusuar në diskutim me Drejtorët e Bujqësisë
- Një (1) grup i fokusuar në diskutim me Drejtorët e Arsimit,
- Një (1) grup i fokusuar në diskutim me Drejtorët e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
- Një (1) grup i fokusuar në diskutim me Drejtorët e Administratës
- Një (1) grup i fokusuar në diskutim me Drejtorët e Shërbimeve Publike

Diskutimet në grupe u ndanë në kategori, ashtu që të përfaqësonin kolegjiunet e AKK-së. Fokus grupet u ofruan drejtorëve komunal mundësinë për të diskutuar modelet e tyre të punës dhe shkëmbimin e praktikave të mira sa i përket menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19. Në këto takime, anëtarët patën mundësinë të diskutojnë në mënyrë më të detajuar dhe konkrete situatën e shkaktuar nga përhapja e virusit dhe në të njëjtën kohë të përshkruajnë nevojat e tyre emergjente për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Të ftuarit potencial për pjesëmarrje në grupe të fokusuar të diskutimit u zgjedhën nga listat e drejtorëve që u ofruan nga AKK, të përdorura edhe për pyetësonin online. Për të prodhuar listat e drejtorëve të mundshëm për diskutime, UBO Consulting përdori metodologjinë e përzgjedhjes së rastësishme, metodë përmes së cilës, drejtorët u ndanë në bazë të drejtorive ose kolegjiunëve.

Në këtë studim, UBO Consulting rekrutoi deri në dymbëdhjetë drejtorë komunalë për një diskutim, në mënyrë që të zvogëlonte numrin e mos-pjesëmarrjes. Të gjithë pjesëmarrësit e konfirmuar u kontaktuan paraprakisht një ditë më herët, në mënyrë që t'ua kujtojmë orën e takimit që do mbahej online, si dhe për të konfirmuar, edhe një herë, pjesëmarrjen e tyre,

Duke marrë parasysh situatën e krijuar nga COVID-19, diskutimi u zhvillua përmes platformave online. Fokus grupet u përbënë nga gjithsej 90 drejtorë nga drejtoritë / kolegjiomet e zgjedhura.

4. REZULTATET E STUDIMIT

Seksionet e mëposhtme paraqesin rezultatet e gjeneruara nga pyetësi online dhe grupet e fokusuar të diskutimit me përfaqësuesit e komunave, përkatësisht kryetarët e komunave dhe drejtorët komunalë, mbi nevojat emergjente dhe ndikimin socio-ekonomik të pandemisë COVID-19 në qeverinë lokale në Kosovë. Ky hulumtim adresoi tema të ndryshme, duke përfshirë vështirësitë kryesore që kanë hasur komunat gjatë pandemisë, masat e marra nga komunat për të menaxhuar situatën, bashkëpunimin me institucionet e nivelit qendror dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës, si dhe nevojat emergjente të këtyre komunave për ballafaqimin me situatë aktuale dhe tejkalimin e pasojave të shkaktuara nga COVID-19.

Rezultatet nga pyetësi online dhe rezultatet e grupeve të fokusuar të diskutimeve janë integruar në të njëjtat tema, në rastet e trajtimit të çështjeve të ngjajshme.

4.1. Rezultatet nga Pyetësi i Kryetarëve të Komunave

Gjithsej, 29 kryetarë të komunave morrën pjesë në këtë studim. Përmes këtij studimi, këta të fundit patën mundësinë të shprehin vlerësimet e tyre për çështje të caktuara, duke përfshirë vështirësitë me të cilat u përballën komunat që nga përhapja e pandemisë COVID-19, masat e marra nga komunat për menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, bashkëpunimin me institucionet e nivelit qendror dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës, si dhe nevojat emergjente të komunave për të menaxhuar dhe kapërcyer situatën e shkaktuar nga pandemia COVID-19.

4.1.1. Vështirësitë me të cilat u përballën komunat që nga përhapja e pandemisë COVID-19

Pyetja fillestare e intervistës gjysmë të strukturuar kishte për qëllim identifikimin e vështirësive me të cilat u përballën kryetarët e komunave që nga përhapja e pandemisë COVID-19. Duke pasur parasysh këtë, pjesëmarrësve iu kërkua të renditnin vështirësitë kryesore me të cilat u përballën gjatë administrimit të rrethanave të shkaktuara nga COVID-19 brenda komunave të tyre.

Në këtë kontekst, përgjigjet e kryetarëve të komunave variuan prej mungesës së fondeve, buxhetit të limituar deri tek mungesa e përgaditjes ekonomike për një situatë të tillë pandemike. Çështja e buxhetit të kufizuar, si rrjedhojë, ka shkaktuar vështirësi të tjera midis kryetarëve të komunave, të tilla si pamundësia e alokimit të buxhetit në masa të mjaftueshme për sigurimin e materialit mbrojtës si maska, doreza, dezinfektues dhe mjete të tjera esenciale pandemike.

Në të njëjtën temë, duke u thelluar në atë se cila do të ishte vështirësia e dytë më e hasur në aspekt të administrimit të pandemisë COVID-19, pjesëmarrësit theksuan çështje të tilla si mungesa e stafit mjekësor, pezullimi i projekteve kapitale të parashikuara për t'u ekzekutuar në këtë vit, dhe ulja e të hyrave vetanake komunale. Për më tepër, një numër i konsiderueshëm i pjesëmarrësve deklaruan se pandemia COVID-19 ka rritur dukshëm numrin e familjeve në nevojë. Në anën tjetër, kryetari i komunës së Kllokotit, i dha rëndësi të veçantë çështjeve psikologjike dhe problemeve të shëndetit mendor të qytetarëve gjatë kësaj periudhe të izolimit dhe vështirësive ekonomike.

Një gjetje tjetër e identifikuar ishte fakti që kryetarët e komunave ishin të papërgatitur dhe jo të trajnuar për situatën që pasoi. Të qenit pa përvojë rezultoi në vështirësi në menaxhimin dhe funksionimin e komunave në rrethanat e ndodhura.

Për më tepër, siç përshkruan grafiku i mëposhtëm, kryetarët e komunave u pyetën se sa të përgatitur ishin komunat e tyre për t'u përballur me një situatë pandemike. Përderisa shumica e kryetarëve të komunave (21 nga 29) deklaruan se ata konsiderojnë se komunat e tyre kanë qenë deri diku të përgaditura, një numër i vogël i atyre (7 nga 29) pohuan se ishin përgatitur mirë për të menaxhuar situatën. Nga ana tjetër, kryetari i komunës së Vushtrrisë ishte i vetmi që deklaroi se ata ishin kryesisht të papërgatitur për një gjendje të tillë pandemike.




Figura 1. Niveli i përgatitjes në trajtimin e një situatë të tillë pandemike

4.1.2. Masat e ndërmarra nga komunat për të menaxhuar situatën e krijuar nga pandemia COVID-19

Për të kuptuar edhe më tej masat e menjëhershme të adresuara nga komunat, respondentët u pyetën rreth masave të ndërmarra në përpjekje për të menaxhuar situatën e krijuar nga pandemia COVID-19. Si rezultat, pjesëmarrësit shprehën veprime të ndryshme të përshtatura për menaxhimin e situatës, siç janë ndarja e një fondi emergjent prej 200.000 € për familjet në nevojë, dhe respektimin e rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike në Kosovë (referuar tutje si IKSHPK), me qëllim parandalimin e përhapjes së mëtejshme të virusit. Për më tepër, kryetari i komunës së Vushtrrisë deklaroi që në bashkëpunim me fermerët dhe prodhuesit e tjerë të vegjël, themeluan grupe në mënyrë që të mund të shesin produktet e tyre direkt, duke marrë parasysh faktin se ky grup u ndikua shumë nga pandemia.

Duke marrë parasysh efektet që pandemia COVID-19 shkaktoi në mirëqenien psikologjike dhe shëndetin e përgjithshëm mendor të qytetarëve, kryetarët e komunave të Suharekës dhe Prizrenit krijuan një platformë në internet për ofrimin e konsulentë psikologjike falas. E njëjta qasje është adaptuar edhe nga komuna e Mitrovicës, ku përveç kësaj, janë marrë edhe masa të tjera si shpërndarja e pamfleteve me informata në lidhje me pandeminë, caktimi i dy objekteve të mëdha si karantinë dhe lokacione trajtimi për rastet emergjente, si dhe organizimi i ekipeve emergjente për të monitoruar dhe ekzaminuar udhëtarët në pikën kufitare të Bërnjakut.

Për më tepër, interes i veçantë në këtë studim i është vënë identifikimit të masave të ndërrmara nga kryetarët e komunave gjatë pandemisë COVID-19 drejt katër kategorive që konsiderohen më të rrezikuara:

- Personat me nevoja të veçanta,
- Të moshuarit,
- Gratë, dhe
- Banorët e zonave rurale.

Sa i përket kategorisë së parë, duke marrë parasysh masat që pjesëmarrësit ndërmorën për të mbështetur individët me nevoja të veçanta, përgjigjet e tyre ishin mjaft të ngjashme. Shumica e kryetarëve të komunave deklaruan se ata i ofruan kësaj kategorie pako ushqimore, artikuj higjienik, ilaçe dhe vizita mjekësore falas. Përveç kësaj, kryetari i komunës së Mitrovicës, shprehu vështirësitë e tij në identifikimin e kërkesave të kësaj kategorie, për të cilat ai kërkoi mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile të cilat punojnë me individë me nevoja të veçanta.

Së dyti, kur u pyetën për veprimet që komunat ndërmorën për të ndihmuar të moshuarit gjatë pandemisë COVID-19, nuk kishtë dallime ndërmjet përgjigjeve. Pjesëmarrësit sqaruan se ata kishin siguruar pako ushqimore, ilaçe, shujta ditore dhe vizita mjekësore falas, për këtë kategori. Për më tepër, ekipe mjekësore u dërguan për të kryer kontrolla mjekësore ndaj të moshuarve në secilën shtëpi në komunën e Mitrovicës. Më tej, kryetari i komunës së Vushtrrisë u shpreh se ata kishin angazhuar një staf vullnetar për të ndihmuar të moshuarit që kanë mungesë të kujdesit bazik shëndetësor dhe social, si dhe kishin krijuar një linjë telefonike ndihmuese falas për të moshuarit në nevojë.

Për më tepër, një vështrim i veçantë u vendos në masat e angazhuara nga komunat drejtuar grave gjatë kësaj periudhe. Në këtë aspekt, shumica e kryetarëve të komunave deklaruan se kjo kategori u ndihmua në përputhje me kërkesat e tyre individuale. Masa të tjera të ndërrmara përfshinë lirin e grave nga puna (d.m.th. duke u dhënë të gjitha grave mundësinë për të punuar nga shtëpia). Për më tepër, kryetari i komunës së Ferizajt deklaroi se një fokus i veçantë ishte vendosur në ndihmën e nënave të vetme dhe viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës.

Si kategori e fundit, ishin përpjekjet dhe veprimet që u ndërmorrën nga kryetarët e komunave për t'u ardhur në ndihmë banorëve që jetojnë në zona rurale. Rezultatet implikuan që kryetarët e komunave vepruan kundrejt kësaj kategorie duke i asistuar me furnizime ushqimore, artikuj higjienik dhe ilaçe. Për shembull, kryetari i komunës së Ferizajt deklaroi se në bashkëpunim me përfaqësuesit e fshatrave, 2000 artikuj ushqimor u shpërndanë banorëve të zonave rurale. Në anën tjetër, masat e ndërrmara nga komuna e Vushtrrisë përfshinin organizimin e ekipeve emergjente COVID-19 në secilin fshat me qëllim të ndihmës së qytetarëve gjatë rrethanave pandemike.

Si pikë përfundimtare, në lidhje me këtë temë të masave të marra nga komunat me qëllim të asistencës ngaj kategorive të përmendura, mund të konkludohet se veprimet e ndërrmara për kategoritë e ndryshme ishin mjaft të ngjashme. Pothuajse të gjitha komunat e përqendruan mbështetjen e tyre në sigurimin e pakove ushqimore, artikujve higjienikë, ilaçeve dhe vizitave mjekësore falas.

Tutje, një vështrim i përgjithshëm në Figurën 2. dëshmon se përdherisa 23 nga 29 komuna kanë rialokuar buxhetin komunal për të luftuar pandeminë COVID-19, 6 nga 29 komuna nuk kanë arritur ta bëjnë këtë. Sa i përket shumës së ndarë për këtë aspekt, ajo ndryshonte nga komuna në komunë, duke filluar me një shumë minimale prej 1000.00 € (Komuna e Kaçanikut) deri në atë prej 326,000.00 € (Komuna e Podujevës), të cilat ishin të destinuara kryesisht për pajisje mbrojtëse, siç janë maska për fytyrë, doreza, dezinfektues dhe pajisje të tjera higjienike, pako ushqimore për familjet në nevojë dhe dezinfektimin e institucioneve publike dhe banesave kolektive.



Figura 2. Rialokimi i Buxhetit Komunal në luftimin e pandemisë COVID-19

Në lidhje me përgatitjen e një Pakoje Emergjente për të ndihmuar bizneset private dhe kategoritë e tjera në nevojë, të dhënat tregojnë se 16 nga 29 komunat në këtë studim kanë dizajnuar një pako të tillë. Shuma e alokuar për këto biznese është përfshirë në shumën e lartpërmendur mbi rialokimin e buxhetit. Sidoqoftë, si mbështetje shtesë për bizneset u miratua vendimi për të liruar bizneset nga taksat për 3 muaj (ose 25% të taksës vjetore) me theks të veçantë në taksat komunale për përdorimin e hapësirave publike, si dhe lirimin nga qeraja për periudhën kohore prej 6 muaj.




Figura 3. Përgatitja e Pakos Emergjente Fiskale për të ndihmuar bizneset private dhe kategoritë e tjera në nevojë

4.1.3. Bashkëpunimi me institucionet e nivelit qendror, që nga përhapja e pandemisë COVID-19 në komuna

Një çështje me rëndësi domethënëse në këtë studim ishte njohja e kërkesave të komunave që u adresuan te nivelet qendrore të qeverisjes sa i përket situatës së krijuar nga pandemia COVID -19.

Siç ilustron në figurë, modeli i komunikimit midis qeverisë lokale dhe qeverisë qendrore duket se ka dalluar nëpër komuna. Përderisa 12 nga 29 komunat janë angazhuar në komunikim sistematik dhe këmbëngulës me institucionet e nivelit qendror, 10 nga 29 komunat shpesh hasën në një bashkëpunim të tillë. Më pak komuna (7 nga 29) deklaruan se kanë hasur në komunikim dhe aktivitete të rralla të bashkëpunimit me qeverinë qendrore.




Figura 4. Bashkëpunimi me institucionet e nivelit qendror, që nga përhapja e pandemisë COVID-19 në komuna

Më tutje, rezultatet e studimit tregojnë se komunat adresuan kërkesa të ngjajshme në lidhje me situatën e shkaktuar nga pandemia. Kërkesat e tyre kryesore u fokusuan rreth nevojës së emergjente për ndihmë financiare dhe mjeteve parandaluese siç ishin maskat, dorezat dhe dezinfektuesit. Për më tepër, shumica e pjesëmarrësve deklaruan se kishin kërkuar edhe ilaçe, duke sqaruar më tej se urgjenca ishte e lartë duke marrë parasysh që ekzistonte mungesë e lartë e tyre nëpër spitale. Gjithashtu, pjesëmarrësit kërkuan informata nga IKSHPK në lidhje me numrin e rasteve të COVID-19 në komunat e tyre, ku për këtë, ata shprehën kritikën e tyre drejtuar IKSHPK-së, duke sqaruar se mënyra e vetme për të arritur deri te ky lloj informacioni ishte përmes platformave të rrjeteve sociale.

Më tej, vlen të përmendet se kryetari i komunës së Mitrovicës drejtoi kërkesën për lejimin e vazhdimin të punës në projekte të infrastrukturës në mënyrë që qytetarët të pajisen me ujësjellës dhe kanalizim të cilat ishin thelbësore për higjienën, gjë që konsiderohej esenciale për luftimin e kësaj pandemie.

Sa i përket shkallës në të cilën qeveria qendrore ka arritur të adresojë kërkesat e komunave, vetëm 2 nga 29 komuna pohuan se qeveria i ka adresuar plotësisht kërkesat e tyre, ndërsa 10 nga 29 pohuan se qeveria nuk ka arritur t'i përmbushë ato pritje. Sidoqoftë, 17 nga 29 komuna pohuan se kërkesat e tyre ishin adresuar deri diku.




Figura 5. Vlerësimi i bashkëpunimit me institucionet e nivelit qendror / ministritë e linjës, që nga përhapja e pandemisë COVID-19 në komuna

4.1.4. Bashkëpunimi me Asociacionin e Komunave të Kosovës, që nga përhapja e pandemisë COVID-19 në komuna

Ky studim, ndër të tjera, synon të hedhë dritë në kërkesat që i janë drejtuar AKK-së nga kryetarët e komunave të Kosovës. Ngjashëm me pjesët e mësipërme, pjesëmarrësve iu është kërkuar të vlerësojnë nivelin e komunikimit që ata kishin me AKK-në dhe të rendisnin kërkesat që u adresuan, në mënyrë që të hulumtohen më tej nevojat e tyre emergjente në lidhje me situatën e krijuar nga pandemia COVID-19.

Shumica e kryetarëve të komunave (21 nga 29) kanë komunikuar vazhdimisht me AKK-në, që nga përhapja e COVID-19. Nga ana tjetër, komunat e mbetura e kanë përshkruar komunikimin e tyre si të shpeshtë (5 nga 29) dhe të rrallë (1 nga 29). Vetëm dy nga 29 komuna raportuan një mungesë të plotë të komunikimit me AKK-në.




Figura 6. Bashkëpunimi me Asociacionin e Komunave të Kosovës, që nga përhapja e pandemisë COVID-19 në komuna

Sipas rezultateve të hulumtimit, pjesëmarrësit dhanë përgjigje të ndryshme sa u përket kërkesave kryesore që iu adresuan AKK-së në lidhje me situatën pandemike COVID-19. Një numër i pjesëmarrësve deklaruan se kërkesat e tyre kishin të bënin kryesisht me numrin e rasteve të COVID-19 në komunat e tyre, zbatimin e projekteve të mëdha kapitale, përfshirjen e profesionistëve të tjerë si inspektorët, punëtorët e administrimit të mbeturinave dhe zyrtarët e komunave në Pakon Emergjente Fiskale, si dhe mbështetjen e fermerëve përmes lejimit të aktivitetit të tyre gjatë periudhës së kufizimit të lëvizjes.

Për më tepër, kryetarët e komunave të Shtimes dhe Junikut shtjelluan më tej mbi kërkesat drejtuar AKK-së, (i.e. të heqen pengesat administrative gjatë blerjes së mjeteve parandaluese dhe ndihmën në zbutjen e stigmatizimit të vendosur mbi individët e infektuar me virusin COVID-19). Kryetari i Komunës së Shtimes gjithashtu rekomandoi që Qeveria të ndihmojë fermerët duke blerë produktet e tyre dhe duke u shpërndarë atyre tek qytetarët në nevojë, kështu duke mundësuar që dy grupet të përfitojnë.

Të dhënat e përmbledhura në grafikun e mëposhtëm, zbuluan se 20 nga 29 komuna kanë konsideruar se AKK-ja i ka adresuar plotësisht kërkesat e tyre në nivelin qendror. Nga ana tjetër, 9 nga 29 komuna pohuan se AKK ka arritur të adresojë kërkesat e tyre deri në një masë të caktuar.




Figura 7. Vlerësimi i bashkëpunimit me Asociacionin e Komunave të Kosovës, që nga përhapja e pandemisë COVID-19 në komuna

4.1.5. Nevojat emergjente të komunave për të menaxhuar dhe kapërcyer situatën e shkaktuar nga pandemia COVID-19

Qëllimi i domosdoshëm i këtij studimi ishte të hulumtojë nevojat emergjente të komunave që duhen përmbushur në mënyrë që të menaxhohet dhe tejkalohet situata e krijuar nga pandemia COVID -19. Rezultatet e studimit tregojnë se mbështetja financiare dhe fondet janë identifikuar si nevoja emergjente për komunat në mënyrë që të zbuten me sukses pasojat pandemike COVID -19. Sidoqoftë, pjesëmarrësit shprehën se nevoja të tjera emergjente, siç janë masat parandaluese, ndihma financiare për fermerët, punësimi sezonal për individët që jetojnë me ndihmë sociale dhe koordinimi më i mirë ndërmjet niveleve qendrore dhe lokale të qeverisjes do të kishin rëndësi esenciale në tejkalimin e situatës.

Për më tepër, kryetarët e komunave të Hanit të Elezit dhe Podujevës janë shprehur se janë në nevojë emergjente të ekipeve mjekësore në vijat e kontrollit kufitar të Hani i Elezit dhe Merdarë-s, duke lënë të kuptohet se komunat nuk janë në gjendje të mbulojnë këto pika me staf të nevojshëm mjekësor.

Në anën tjetër, kryetari i komunës së Obiliqit në përgjigje të pyetjes së shtruar dha rekomandimin që buxheti i paraparë për projektet kapitale të këtij viti i cili nuk është ekzekutuar për shkak të shfaqjes së pandemisë COVID- 19, të kursehet dhe transferohet në projektet e vitit të ardhshëm.

Për të zgjeruar mirëkuptimin mbi shqetësimet më të mëdha me të cilat përballen kryetarët e komunave në lidhje me masat që duhet të merren nga Qeveria për të lehtësuar pengesat e krijuara nga pandemia COVID- 19, nga pjesëmarrësit u kërkua të shprehin gjykimin e tyre për masat që ata konsideronin si të përshtatshme për t'u ekzekutuar nga qeveria, duke pasur parasysh situatën.

Shumica e kryetarëve të komunave deklaruan se qeveria duhet të përqëndrohet në mbështetjen e komunitetit të biznesit. Për më tepër, ata sqaruan se qeveria qendrore duhet të mbështesë kategoritë që mbetën të përjashtuara nga pakoja emergjente fiskale si: fermerët, nënat dhe fëmijët. Më tej, duke pasur parasysh buxhetin e pamjaftueshëm, pjesëmarrësit deklaruan se Qeveria duhet të kompensojë shpenzimet e komunave të bëra gjatë menaxhimit të situatës së krijuar si rrjedhojë e pandemisë COVID -19.

Sidoqoftë, në një aspekt më pozitiv, kryetari i Komunës së Gjakovës beson se Qeveria po merr të gjitha masat e kërkuara në mënyrë që të ndihmojë të gjitha komunat në menaxhimin dhe tejkalimin e rrethanave të krijuara nga pandemia COVID -19.

Gjithashtu, ky studim trajtoi masat e ndërmarra nga organizata të ndryshme bamirësie, institucione huazimi ose organizata për të tejkaluar situatën pandemike COVID-19. Si rrjedhojë, shumica e pjesëmarrësve deklaruan se duke marrë parasysh rrethanat aktuale, çdo ndihmë do të ishte e dobishme.

Sidoqoftë, kryetari i komunës së Rahovecit theksoi se ekziston nevoja emergjente për avancimin e teknologjisë informative (i.e. projektet që do të zbatohen në mënyrë virtuale nuk mund të zhvillohen për shkak të numrit të pamjaftueshëm të kompjuterëve në komunë). Përveç kësaj, pjesëmarrësit shprehën mirënjohjen e tyre ndaj organizatave të shumta si Kryqi i Kuq, Këshilli Islamik, Jetimët e Ballkanit dhe Diaspora. Ata pohuan se ndihma e mëtutjeshme për sigurimin e telefonave falas ose pajisjeve të tjera elektronike për fëmijët që nuk kanë mjetet e nevojshme për të ndjekur mësimet online do të vlerësohej jashtëzakonisht shumë.

Pjesa e fundit e këtij seksioni trajtoi çështjet që kanë rëndësi të madhe për t'u adresuar tek qeveria përmes AKK-së, duke i kushtuar vëmendje të veçantë legjislacionit. Përgjigjet e pjesëmarrësve preken çështje të ndryshme, të cilat janë të listuara më poshtë:

- Propozimi i një ligji të ri që mbulon menaxhimin e situatave të ngjashme pandemike,
- Thjeshtësimi i procedurave të prokurimit, dhe
- Ofrimi i kompetencave financiare shtesë qeverisjes lokale.

Sidoqoftë, shumica e pjesëmarrësve deklaruan besimin e tyre se AKK po ofron ndihmë të madhe mbi adresimin e kërkesave të komunave ndaj qeverisjes qendrore.

4.2. Rezultatet nga Anketa me Drejtorë

Drejtorët komunalë ishin poashtu pjesë e këtij studimi. Përkatësisht, një numër prej 226 intervistave të gjysmë-strukturuara u zhvilluan me këtë grup. Sikurse kryetarët komunal, edhe drejtorët komunal u pyetën për temat e njëjta. Sidoqoftë, atyre u është kërkuar të japin përgjigjet e tyre më shumë nga këndvështrimi i drejtorive, sesa nga perspektiva e komunave.

4.2.1. Vështirësitë me të cilat u përballën drejtoritë që nga përhapja e pandemisë COVID-19

Fillimisht, nga drejtorët komunal u kërkuar të përshkruajnë vështirësitë me të cilat drejtoritë e tyre janë ballafaquar, që nga përhapja e pandemisë COVID-19. Ata patën mundësinë të adresojnë një numër të madh vështirësish, pa kufizime. Në përgjithësi, shumica e drejtorëve komunalë përmendën vështirësitë e zakonshme me të cilat u ballafaquan gjatë përhapjes së pandemisë COVID-19. Vështirësia më e përmendur nga të gjithë drejtorët ishte mungesa e pajisjeve mbrojtëse, siç janë maskat, dorëzat dhe dezinfektuesit. Gjithashtu, rritja e çmimeve të produkteve të mëparshme u konsiderua si një padrejtësi ndaj qytetarëve, duke marrë parasysh situatën e tyre socio-ekonomike, që poashtu i ka penguar ata të kenë mundësi për t'u mbrojtur siç duhet nga virusi.

Për më tepër, nuk ishte për t'u habitur që vështirësia kryesore e përmendur nga drejtorët komunal në përgjithësi ishte mungesa e buxhetit dhe fondeve komunale për të mbuluar shpenzimet si pasojë e pandemisë. Si rezultat, shumë drejtorë e shohin ndarjen e buxhetit si një nga vështirësitë e hasura gjatë kësaj periudhe emergjente. Koha e marrjes së vendimeve për ndarjen e buxhetit ishte e shpejtuar dhe e shkurtër, duke e bërë të vështirë vlerësimin se cilët sektorë duhet të kenë përparësi gjatë alokimit, kjo e fundit duke marrë parasysh joefikasitetin e drejtorëve në raste të tilla emergjente. Me ndalimin e lëvizjes së qytetarëve dhe mbylljen e bizneseve, të ardhurat komunale kishin rënë ndjeshëm gjatë kësaj periudhe. Kjo rezultoi në një rritje të numrit të qytetarëve të papunë.

Komunikimi mes nivelit lokal dhe qendror konsiderohet të jetë një ndër pikat kyçe në menaxhimin e situatave të tilla. Sidoqoftë, një numër i madh i drejtorëve të intervistuar për këtë hulumtim thanë se kanë pasur vështirësi në komunikim me ministrinë e linjës.

Ajo që mund të dallohet nga përgjigjet e drejtorëve të ndryshme janë përgjigjet e tri drejtorëve të veçanta, **drejtorisë së Arsimit, Bujqësisë dhe drejtorisë së Shëndetit dhe Mirëqenies Sociale. Drejtorët e Arsimit** deklaruan që organizimi i mësimeve përmes internetit shkaktoi shumë vështirësi në mes të komunave. Mungesa e teknologjisë, si kompjuterët personalë dhe telefonat e mençur, në mesin e banorëve të tyre, veçanërisht në zonat rurale, ndikuan në shfaqjen e vështirësive gjatë zhvillimit të mësimit në këtë mënyrë. Si pasojë, shumë nxënës nuk kanë ndjekur mësimin në internet, gjë që rrjedhimisht do të ndikojë në rezultatet e vlerësimit të tyre. Për më tepër, përveç mungesës së mjeteve kompjuterike në mesin e qytetarëve të komunave, drejtori i Arsimit në Pejë deklaroi se kishte një pjesëmarrje të ulët të Komunitetit Rom, Komunitetit Ashkali dhe Komunitetit Egjiptian në mësimin përmes internetit.

“Deri tani, kemi pranuar 170 pajisje, si tabletë dhe kompjuterë, nga organizata humanitare të dedikuara për nxënësit të cilët nuk kanë mundësi financiare për t’i përballuar shpenzimet e tilla. Nëse ka mundësi që nxënësit të mos kthehen në shkollë në Shtator, ne bëjmë kërkesë që qeveria të paguaj për platformën e-shkollimi; duke e mbështetur këtë kërkesë në premisën që nxënësit janë duke u detyruar të paguajnë për të marrë pjesë në ligjërata” – Drejtor i Edukimit në Komunën e Vushtrrisë/Vucitrn

Sa i përket **drejtorëve të Bujqësisë**, përveç kërkesave të përgjithshme të përshkruara në paragrafet më lart, ata kanë hasur në vështirësi të veçanta lidhur me drejtoritë e tyre. Mungesa e tregut gjatë periudhës së pandemisë dhe masat mbrojtëse të ndërmarra nga komunat, sikurse karantinimi i komunave dhe kufizimi i lëvizjes së qytetarëve, kanë ndikuar në rënien e shitjeve të produkteve bujqësore. Për më tepër, ndalja e aktivitetit të gastronomisë shkaktoi në rënien e shitjeve të prodhimeve të freskëta. Çfarë bëri situatën e kësaj drejtorie edhe më të vështirë ishin kërkesat e bujqve për lirinë e lëvizjes së tyre. Siç u tha nga këta drejtorë, mungesa e komunikimit të mirëfilltë me Ministrinë e Bujqësisë ndikoi në shtyrjen e realizimit të kërkesave të bujqve.

“Një nga vështirësitë kryesore që kemi hasur ishte pamundësia për të ekzekutuar projekte të lidhura me bujqësinë që supozoheshin se do të ekzekutohen në një afat kohor të caktuar. Deri tani, vetëm një projekt është zhvilluar, specifikisht projekti i serrave. Sektorët e mishit dhe zogjve janë dëmtuar më së shumti, për shkak se varen plotësisht në të ardhurat nga emigrantët. Fatkeqësisht, buxheti i ndarë për drejtorinë tonë është 92.000 € (subvencione dhe transfere), kështu ne nuk kishim mundësi të ndihmonim. Sidoqoftë, ne po mundohemi të ofrojmë ndihmë përmes kredive për fermer, për të cilat ne do të paguajmë interesin, dhe fermerët do të kenë mundësi të ripaguajnë në një periudhë tri-vjeçare.” – Drejtor i Bujqësisë në Komunën e Mitrovicës

Bazuar në këto rezultate, **drejtorët e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale** poashtu përmendën vështirësi më specifike se të tjerët. Duke marrë parasysh ballafaqimin me një virus të panjohur, mungesa e informative për COVID-19 në fillim të përhapjes së tij u përmend si vështirësia më e madhe e kësaj drejtorie. Sipas tyre, kjo ka ndikuar në rritjen e panikës mes qytetarëve. Sidoqoftë, edhe me rritjen e panikut, u kuptua dukshëm se kishte mungesë të vetëdijes së thellë në mesin e qytetarëve për mbrojtjen nga virusi. Kështu, drejtorët thanë se kjo ka shkaktuar vështirësi në përmbajtjen e rekomandimeve të IKSHPK-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

Përpos këtyre vështirësive, sipas drejtorëve të Shëndetësisë, mungesa e stafit mjekësor në komuna dhe mungesa e pajisjeve mbrojtëse, e kanë vështirësuar menaxhimin e kësaj shtate. Komunat e Gjilanit/Gnjilane, Prizrenit/Prizren dhe Hanit të Elezit/ Elez Han, të përcaktuara për të mbikqyrur vendkalimet kufitare, kanë hasur vështirësi shtesë nga komunat tjera. Drejtorët e Shëndetësisë nga këto komuna thane se drejtoritë e tyre janë ballafaquar me mungesë të stafit për të mbuluar pikat kufitare, dhe mungesë të pajisjeve mbrojtëse për stafin e përcaktuar në ato pika kufitare. Poashtu, mungesa e automjeteve dhe ndalimi i transportit publik ka penguar lëvizjen e stafit mjekësor.

“Në komunën tone, deri tani ka gjashtëmbëdhjetë raste të shëruara nga COVID-19. Problemi jonë me këtë çështje ishte se nga ato gjashtëmbëdhjetë raste, shtatë ishin punëtorë shëndetësor. Sidoqoftë, asnjë shërbim nuk ka mbetur pa u ofruar, kjo falë ndihmës nga disa vullnetarë të përcaktuar përmes Ministrisë së Shëndetësisë. Poashtu, momentalisht, ne konsiderojmë veten të pajisur mjaft mire me masa mbrojtëse si maska, dorëza dhe dezinfektues.” – Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Obiliqit/Obilic

Çka mund të shtohet për vështirësitë e hasura nga drejtoria e përmendur më lart ishte identifikimi i familjeve në nevojë, numri i të cilave është rritur ndjeshëm, sidomos gjatë kësaj periudhe. Bazuar në rezultatet e studimit, mungesa e buxhetit ka bërë të vështirë marrjen e ndihmës sociale nga këto familje, përfshirë ushqimin dhe pakot higjienike.

Duke konsideruar vështirësitë e hasura gjatë menaxhimit të kësaj situatë, poashtu edhe masat e ndërmarra nga drejtoritë, më shumë se gjysma e drejtorëve (61%) konsideruan se drejtoritë e tyre janë deri diku të përgatitura kundrejt situatës pandemike.




Figura 8. Niveli i përgatitjes në trajtimin e një situatë të tillë pandemike

Ndër të tjerash, ky studim kishte për qëllim të nxirrte në pah se cilët sektorë brenda komunave janë prekur më së shumti nga pandemia COVID-19. Duke u bazuar në të dhënat e analizuara, një numër i pjesëmarrësve thanë se të gjithë sektorët janë prekur në mënyrë të barabartë. Mirëpo, u dalluan përgjigje specifike të veçanta nga secila drejtori.

Drejtoria e Administratës

Në lidhje me sektorët më të prekur nga pandemia COVID-19 brenda drejtorisë së Administratës, përgjigjet e drejtorëve ishin mjaft të ngjashme. Pjesëmarrësit deklaruan se sektorë të tillë si sektori i gjendjes civile, zyra e arkivave dhe stafi i shërbimeve të administratës janë prekur në masë të madhe nga pandemia. Sidoqoftë, sektorë të tjerë të ndikuar në përgjithësi nga pandemia COVID -19 ishin punonjësit e sigurimit, zyra e pritjes dhe sektori i regjistrimit civil.

Drejtoria e Arsimit

Bazuar në përgjigjet e pjesëmarrësve lidhur me sektorët më të prekur brenda drejtorisë së arsimit, nxënësit, specifikisht ata të shkollave të mesme, u përmendën si më të prekurit nga kjo pandemi. Për më tepër, drejtori i komunës së Junikut deklaroi se sektori privat hasi më së shumti vështirësi, duke konsideruar se mësuesit në sektorin privat ishin të nënpaguar, edhe pse ishin të angazhuar vazhdimisht në procesin e mësimit virtual.

Drejtoria e Bujqësisë

Sipas rezultateve, pjesëmarrësit që përfaqësuan drejtorinë e Bujqësisë deklaruan se sektorët e mishit, bimëve dhe serrave janë sektorët më të prekur nga pandemia. Për më tepër, dy sektorët që pjesëmarrësit konsideruan se janë në rrezik të madh, janë sektorët e blegtorisë dhe bujqësisë. Përveç kësaj, drejtori i Bujqësisë në komunën e Vushtrrisë deklaroi se pamundësia për vendosjen e produkteve bujqësore në sektorin e gastronomisë, ka dëmtuar ndjeshëm sektorin e bujqësisë.

Drejtoria e Buxhetit dhe Financave

Duke kuptuar se të gjitha drejtoritë janë të ndërlidhura me drejtorinë e Buxhetit dhe Financave, ishte tejet e rëndësishme të adresohen sektorët më të prekur brenda kësaj drejtorie. Përgjigja më e zakonshme e pjesëmarrësve ishte se sektori i tatimit në pronë rezultoi të jetë më i prekuri nga pandemia COVID-19. Për më tepër, sektorët e financave dhe inspeksionit janë konsideruar poashtu si tejet të prekur nga situata e krijuar nga pandemia.

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Bazuar në rezultatet e studimit, duke konsideruar pasojat e pandemisë në sektorë individual brenda drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, pikëpamjet e pjesëmarrësve ishin mjaft homogjene. Shumica e pjesëmarrësve deklaruan se ndërprerja e aktiviteteve sportive, siç janë ndeshjet e ndryshme, theksuan se sektori i sportit ishte më i prekuri nga kjo situatë.

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Duke konsideruar se drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale kishte një rol esencial në përballjen me situatën e krijuar nga pandemia, ishte e rëndësishme të adresoheshin sektorët më të ndikuar në këtë drejtori. Bazuar në përgjigje të pjesëmarrësve, u nënkuptua që stafi mjekësor, si mjekët dhe infermierët, të cilët ishin përballur me një sfidë të re dhe të panjohur, orar të gjatë pune, mungesë të pajisjeve mbrojtëse dhe faktin se ata kanë qenë vija e parë kundër virusit, e bëri këtë grupin më të prekurin e kësaj drejtorie. Poashtu, sektorët tjerë si mirëqenia sociale dhe sektori financiar ishin ndër sektorët e prekur nga kjo pandemi.

Drejtoria e Shërbimeve Publike

Duke nxjerrë në pah ndikimin e pandemisë COVID-19 në sektorët e drejtorisë së Shërbimeve Publike, rezultatet e studimit tregojnë se sektorët e komunikimit, mjedisit, investimeve kapitale dhe turizmit ishin më të prekurit nga kjo situatë. Poashtu, pjesëmarrësit deklaruan se departamenti i emergjencës u ndikua në staf dhe periudhë të reagimit, për shkak të rolit të tyre esencial gjatë kësaj pandemie. Në anën tjetër, drejtori i komunës së Shtërpcës deklaroi se asnjë sektor brenda drejtorisë së tij nuk është prekur nga pandemia.

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik

Në bazë të përgjigjeve të marra lidhur me sektorët brenda drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, të cilat janë ndikuar më së shumti nga pandemia, u kuptua se gastronomia, tregtia, ndërtimtaria dhe institucionet tjera të sektorit privat, ishin target i ndikimit negativ të kësaj pandemie. Sidoqoftë, pjesëmarrësit thanë se sektorët tjerë si agrokultura, turizmi dhe sektorët e efikasitetit ekonomik janë prekur poashtu.

1.1.1. Masat e ndërmarra nga drejtoritë për të menaxhuar situatën e krijuar nga pandemia COVID-19

Tutje, drejtorëve komunal iu kërkua të listojnë masat që ata kanë ndërmarrë, në mënyrë që të menaxhojnë situatën e krijuar nga pandemia COVID-19.

Në përgjithësi, shumica e drejtorëve komunal përmendën masat e njëjta prioritare të ndërmarra për të menaxhuar situatën e krijuar nga pandemia COVID-19. Dezinfektimi i hapësirave të drejtorive, pajisja e stafit me masa mbrojtëse, reduktimi i stafit dhe puna me rotacion, u përmendën si masa të ndërmarra nga të gjithë drejtorët pjesëmarrës në këtë hulumtim. Poashtu, tek të gjitha drejtoritë, është krijuar një staf emergjent (staf krize) në nivel komunal, të cilët kishin qëndrim të detyrueshëm ditor. Për më tepër, lirimi i stafit mbi moshën 55 vjeç ishte një nga masat e marra për të mbrojtur shëndetin e punëtorëve të drejtorive. Sidoqoftë, kishte disa dallime në përgjigjet e drejtorëve sa i përket masave që i përkisnin vetëm sektorëve të drejtorive të tyre.

Drejtoria e Buxhetit dhe Financave

Ndryshe nga drejtoritë e tjera, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave u ka ofruar mbështetje financiare komunave të tyre. Përmes kësaj drejtorie, fondet janë shpërndarë gjatë periudhës pandemike. Poashtu, kjo drejtori ka ndihmuar në përgatitjen e pakos emergjente. Informimi i përgjithshëm i bizneseve mbi vendimet e qeverisë dhe angazhimi i sektorit të inspektimit në ofrimin e kontratave për bizneset për respektimin e masave dhe rregullave të përcaktuara nga IKSHPK, u konsideruan si masat e marra nga këta drejtorë.

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Përveç masave të përgjithshme të ndërmarra nga të gjitha drejtoritë, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka ndërmarrë masa të veçanta, duke marrë parasysh se ata ishin drejtoria në vijën e parë të frontit, në luftën kundër pandemisë COVID-19. Fillimisht, deklarimi i pademisë si krizë globale ka ndikuar në vendimin e këtyre udhëheqësve për përgatitjen e trajnimeve të stafit në menaxhimin e krizës. Për më tepër, në të gjitha komunat e Kosovës, stafi menaxhues dhe ekipet mobile 24-orëshe janë përcaktuar për të monitoruar rastet e dyshimta të infektimit. Më pas, me përhapjen e virusit në Kosovë, filloi dezinfektimi i hapësirave publike, ndërtesave banesore, parqeve dhe zonave të prekura nga virusi. Në të njëjtën kohë, është bërë pajisja e të gjitha komunave me mjete mbrojtëse, si maska, dorëza dhe dezinfektues, pavarësisht vështirësive me buxhet.

Kjo drejtori poashtu ka përcaktuar stafin për pikat kufitare, të cilët kishin përgjegjësi që të mbikqyrin situatën e personave që hynin dhe dilnin nga Kosova. Në rast nevoje, në disa komuna, është rritur numri i stafit duke punësuar 7 doktorë dhe 3 infermierë. Për më tepër, komunat kanë hapur qendra të thirrjeve, në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar në raste emergjente. Në përgjithësi, të gjitha vendimet dhe rekomandimet nga IKSHPK dhe Ministria e Shëndetësisë janë adresuar me kohë dhe në mënyrë të duhur nga këto drejtori.

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik

Bazuar në rezultatet e studimit, masat e ndërmarra nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik përfshinin: informimi në kohë i bizneseve për të gjitha masat nga niveli qendror në nivelin lokal lidhur me masat që duhet të respektohen nga ta, përgatitja e pakos emergjente, verifikimi i çmimeve të bizneseve, konsultimi i bizneseve lidhur me aplikimet përmes internetit dhe lirimit nga taskat për të gjitha bizneset: lirimi nga taksat për zhvillimin e aktiviteteve biznesore për tre muaj, dhe lirimi nga pagesa e qirasë për përdorimin e pronave komunale për gjashtë muaj.

“Ne kemi adresuar kërkesën tonë kryesore lidhur me mbështetjen e bizneseve nga qeveria. Bazuar në vlerësimin tonë, ne kemi humbur diku 43 milionë euro. Shpenzimet e diasporës gjatë vizitës së tyre në vendin tonë kanë ndikim të madh në ekonominë e vendit. Bizneset kanë kërkuar ndihmë financiare nga komuna në mënyrë që të menaxhojnë situatën e krijuar nga pandemia COVID-19; sidoqoftë, komuna nuk ka mjaftueshëm burime financiare për t’iu përgjigjur këtyre kërkesave.” – Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Decanit

Drejtoria e Arsimit

Duke marrë parasysh se mësimi përmes internetit është organizuar për herë të parë në Kosovë, gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, organizimi dhe mbikqyrja e këtij mësimi ishin ndër masat e para të ndërmarra nga kjo drejtori në fillim të pandemisë. Krijimi i grupit komunikues me menaxherët e shkollave ishte i rëndësishëm në mënyrë që të vlerësohet vazhdimi dhe kualiteti i mësimin në distancë. Kështu, mbledhjet virtuale me drejtorët e shkollave u mbajtën në baza javore, ku u diskutuan udhëzimet e ndryshme nga MASHT, lidhur me situatën e krijuar nga pandemia.

Kjo drejtori poashtu shpërndau pajisje elektronike për nxënësit me kushte të rënda ekonomike dhe inçizoi video-materiale në gjuhën Turke dhe Boshniake nga mësuesit në komunat me pjesëmarrje më të lartë të komuniteteve minoritare. Duhet të theksohet se komuna e Prishtinës/Pristina krijoi platformën E-shkollimi dhe ofroi shërbime psikologjike/terapi të të folurit për nxënësit, shërbime të cilat janë kërkuar edhe nga komunat tjera. Kjo e fundit ishte një intervenim i ndëmarrë edhe nga komuna e Prizrenit.

Drejtoria e Bujqësisë

Bazuar në rezultatet, një nga masat më inovative të ndërmarra nga Departamenti i Bujqësisë, mund të konsiderohet krijimi i Eko Tregut përmes të cilit fermerët mund të shitnin produktet e tyre. Masa të tjera të kësaj drejtorie përfshinin: pajisjen e fermerëve me Certifikatë të Fermerëve (NIF) për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore, dhe ndihma me pajisje mjekësore në sektorin bujqësor.

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Që nga fillimi i pandemisë, drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka ndërprerë të gjitha aktivitetet e drejtorisë së tyre, qoftë ato kulturore, rinore apo sportive. Me këtë vendim, u mbyllën palestrat dhe fushat e sportit. Sidoqoftë, shumë drejtorë janë munduar të gjejnë zgjidhje, në mënyrë që të paktën disa nga aktivitetet e këtyre drejtorive të mbahen përmes platformave të internetit. Këto aktivitete përfshinin teatrot online dhe performancat muzikore, të cilat janë organizuar në komuna. Përmes këtyre aktiviteteve, drejtorët poashtu ndanë subvencione për kategori të ndryshme.

“Të gjitha aktivitetet sportive në komunën e Drenasit janë ndaluar momentalisht. Si pasojë, kjo pengesë e aktiviteteve ka shkaktuar vështirësi të mëdha financiare. Për më tepër, komplikimet financiare poashtu kanë rrjedhur nga mungesa e përkrahjes nga federata të ndryshme të sporteve dhe keq-distribucioni i pakos fiskale emergjente nga qeveria. Sidoqoftë, komuna vazhdon të përkrahë aktivitetet sportive përmes subvencioneve.” – Drejtor i Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Drenasit/Glogovac

Drejtorja e Administratës

Duke marrë parasysh punën me palë, administrata në shumicën e komunave është dashur të vendosë mbrojtës xhami në sektorët e punës me klientë. Përmes kësaj, sipas tyre, mbrojtja e qytetarëve dhe punëtorëve të drejtorisë është rritur. Poashtu, shumica e tyre kanë ndërtuar një platformë online, përmes së cilës mund të nxirren dokumentet e gjendjes civile. Qytetarët mund të gjenin manualin e publikuar lidhur me këtë platformë, i cili iu ndihmonte të gjejnë informacione.

Drejtorja e Shërbimeve Publike

Drejtoritë e Shërbimeve Publike në komuna kanë ndërmarrë masa të ndryshme, bazuar në natyrën e punës së drejtorisë së tyre. Përpos dezinfektimit të rrugëve, objekteve komunale, objekteve arsimore, objekteve religjioze dhe hapësirave publike, ata u fokusuan në pastrimin e zonave me numër të madh të personave të infektuar. Zjarrfikësit kanë intervenuar vazhdimisht në pastrimin dhe dezinfektimin e rrugëve urbane dhe kanë kontaktuar çdo ditë me përfaqësues të fshatrave dhe lagjeve, në mënyrë që të jenë të informuar për të gjitha familjet dhe për raste të mundshme me simptoma të virusit. Për më tepër, ata kanë aktivizuar Qendrën Lokale të Operimeve Emergjente, ku janë identifikuar kërkesat për nevoja emergjente të qytetarëve.

1.1.2. Bashkëpunimi me institucionet e nivelit qendror, që nga përhapja e pandemisë COVID-19 në komuna

Bashkëpunimi me institucionet e nivelit qendror, qysh nga përhapja e pandemisë COVID-19 në komuna, ishte një aspekt tjetër i matur përmes pyetësorit. Kështu, drejtorët komunal u pyetën për bashkëpunimin me ministritë/institucionet e nivelit qendror. Shumica prej tyre (71%) thanë se kanë bashkëpunuar me ministritë e linjës/institucionet e nivelit qendror gjatë përhapjes së pandemisë COVID-19.




Figura 9. Bashkëpunimi me institucionet e nivelit qendror, që nga përhapja e pandemisë COVID-19 në komuna

Ministria e Shëndetësisë (MSH) dhe Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës (IKSHPK)

Duke marrë parasysh se situata e krijuar nga pandemia COVID-19 ishte situatë shëndetësore, të gjitha drejtoritë nga të gjitha komunat thane se kanë bashkëpunuar me Ministrinë e Shëndetësisë (MSH) dhe Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës (IKSHPK). Përmes këtij bashkëpunimi, fillimisht, të gjitha drejtoritë janë informuar për vendimet, udhëzimet dhe rekomandimet.

Bazuar në rezultatet e këtij studimi, kjo ministri ka pajisur të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare, në të gjitha komunat, me mjete mbrojtëse sipas nevojës. Duke konsideruar rekomandimet e këtyre dy institucioneve, drejtoritë përkatëse kanë ndërmarrë vendime për menaxhimin e situates. Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse, ka vendosur të krijojë Qendra Operative, të cilat vepruan 24/7 gjatë periudhës së pandemisë. Poashtu, mund të thuhet se bashkëpunimi është bërë përmes Shtabeve Emergjente, të krijuara në komuna. Anëtarët e këtyre të fundit kanë ndjekur rekomandimet dhe strategjitë për lehtësimin e menaxhimit të situatës. Poashtu, duke konsideruar se shumë komuna janë përcaktuar për të mbikqyrur vendkalimet kufitare, kjo ministri është kontaktuar poashtu për ekipe shtesë shëndetësore për këtë detyrë.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)

Duke marrë parasysh misionin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, i cili është që të ngritet autonomia lokale dhe të fuqizohen aftësitë komunale përmes pjesëmarrjes aktive të qytetarëve dhe përfaqësimit demokratik, të ofrojne shërbime kosto-efektive për të ngritur kualitetin e jetës dhe ekonominë lokale, kjo ministri luajti rolin e njëjtë gjatë periudhës së pandemisë. Bashkëpunimi mes kësaj ministrie dhe Drejtorisë së Administratës përfshiu informimin lidhur me situatën aktuale, bashkëpunimin dhe mbështetjen për situatën e krijuar nga pandemia COVID-19.

Ministria e Financave dhe Transfereve (MFT)

Alokimi i fondeve nga buxheti i vitit 2020, ekzekutimi i kërkesave për transferim dhe alokimi i fondeve në kodin e krijuar për të përballuar pasojat e COVID-19, ishin çështje që përbënin bashkëpunimin midis Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave dhe Ministrisë së Financave dhe Transfereve (MFT). Kjo e fundit kishte lejuar alokime të buxhetit në shumë komuna, për të menaxhuar më mirë situatën.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)

Bazuar në rezultatet, të gjithë drejtorët e Drejtorisë së Arsimit kanë pasur kontakt me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Bashkëpunimi me këtë linjë të ministrisë ka përfshirë rishikimin e çështjes së mësimin online. Për më tepër, ky bashkëpunim ka rezultuar në qartësim lidhur me ligjet për paga dhe pensione në kohën e pandemisë. Vlen të ceket se drejtorët kanë vlerësuar bashkëpunimin me këtë ministri si shumë të kënaqshme, përpos në rastet kur vendimet për arsim janë ndërmarrë në kohë të shkurtër.

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike (MEPTINIS)

Suspendimi i aktiviteteve biznesore gjatë pandemisë, si rezultat i masave preventive të përcaktuara nga institucionet e nivelit qendror, kanë ndikuar këto të fundit të drejtojnë shumë kërkesa lidhur me implementimin e punës tek drejtoritë e Zhvillimit Ekonomik në komunat e tyre. Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, përmes Agjencisë së

Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK), ndihmoi dhe këshilloi në kërkesat e bizneseve. Për më tepër, përmes këtij bashkëpunimi, bizneset u koordinuan dhe u njoftuan lidhur me aktivitetet e tyre ekonomike.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)

Kërkesa e fermerëve për lëvizje të lirë u përmend si arsyeja kryesore për bashkëpunimin në mes të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR). Duke konsideruar vështirësitë e hasura nga sektori i bujqësisë, fermerëve i'u lejua të shesin produktet e tyre gjatë kohës së pandemisë. Sidoqoftë, mungesa e lëvizjes së qytetarëve dhe mungesa e tregut ka shkaktuar dëme të mëdha për këtë kategori.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS)

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) është kontaktuar kryesisht për anulimin e aktiviteteve në këtë fushë. Drejtorët deklaruan se në pajtueshmëri me këtë ministri, ata suspenduan të gjitha aktivitetet kulturore dhe sportive. Mirëpo, përmes këtij bashkëpunimi, ata janë munduar të gjejnë mënyra për të realizuar projektet kapitale, përfshirë këtu realizimin e teatrove online dhe subvencioneve për artistë.

Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administrimit Publik (MPBAP)

Në mënyrë që të ndajnë mes vete eksperiencën profesionale në menaxhimin e situatave emergjente, drejtorët e Shërbimeve Publike kanë bashkëpunuar me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administrimit Publik (MPBAP). Kërkesat për leje për lëvizje të lirë të qytetarëve në nevojë, janë bërë përmes kësaj ministrie. Sipas drejtorëve, ky bashkëpunim ka ndihmuar në koordinimin dhe implementimin e vendimeve dhe masave të ndërmarra nga nivelet lokale.

Mes të tjerash, përfaqësuesit komunal në këtë studim paten mundësinë të shprehin shkallën e kënaqëshmërisë së tyre me linjat e ministries/institucionet e nivelit qendror. Bazuar në rezultatet, më shumë se gjysma e drejtorëve komunal (55%) që morën pjesë në këtë studim ishin “shumë/deri diku të kënaqur” me këtë bashkëpunim; përderisa, 9 përqind deklaruan se janë ‘aspak/deri diku jo të kënaqur’.




Figura 10. Vlerësimi i bashkëpunimit me institucionet e nivelit qendror / ministritë e linjës, që nga përhapja e pandemisë COVID-19 në komuna

1.1.3. Bashkëpunimi me Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK), që nga përhapja e pandemisë COVID-19 në komuna

Mes të tjerash, përfaqësuesit komunal në këtë studim kanë pasur mundësinë të tregojnë nivelin e bashkëpunimit me AKK, që nga përhapja e pandemisë COVID-19. Më shumë se gjysma e drejtorëve komunal (57%) thanë se kanë bashkëpunuar me AKK gjatë kohës së pandemisë.




Figura 11. Bashkëpunimi me Asociacionin e Komunave të Kosovës, që nga përhapja e pandemisë COVID-19 në komuna

Në përgjithësi, bazuar në rezultatet, të gjithë drejtorët kanë pasur vështirësi në kuptimin e vendimeve të ndërmarra nga qeveria në fillim të pandemisë. Në këtë aspekt, AKK ka ndihmuar të sqarojë paqartësitë që drejtorët kanë pasur, sidomos lidhur me udhëzimet e ndryshme mbi masat kundër COVID-19.

Për më tepër, të gjitha çështjet e adresuara tek linjat e ministrisë nga drejtoritë, fillimisht janë adresuar tek AKK. Kjo e fundit ka shërbyer si urë lidhëse mes qeverisë dhe komunave, edhe gjatë kohës së pandemisë. Më konkretisht, AKK ka mbajtur komnatat e informuara lidhur me vendimet e qeverisë, duke ju ofruar sqarime shtesë përmes emailit, grupe të kolegjiemeve në Viber, dhe kur ishte e nevojshme, përmes takimeve direkte.

Bazuar në rezultatet, AKK ka intervenuar për të lehtësuar procedurat e shumta të hasura nga drejtoritë përkatëse. Çështja e tatimeve në pronë, përkatësisht shtyerja dhe heqja e interesit dhe dënimeve për taksapaguesit, është adresuar nga disa drejtorë qysh nga fillimi i pandemisë. Me intervenimin e AKK, Ministri i Financave ka aprovuar këtë kërkesë.

Kërkesa të tjera të listuara nga drejtorët, sikur: lejimi i veprimtarisë të disa ndërmarrjeve (p.sh. atyre të ndërtimitarisë), vazhdimi i punës së operatorëve ekonomik në projekte komunale (me të cilët kishte kontrata), lejimi i lëvizjes së fermerëve për performancën e punës në bujqësi, ndalimi i aktiviteteve të kompanive për mirëmbajtje të rrugëve lokale, ndalimi i lëvizjes së qytetarëve, janë aprovuar me intervenimin e AKK tek ministritë e linjes.

Për më shumë, kërkesa të tjera për AKK përfshinin bashkëpunimin në fuqizimin e rregullave të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale, organizimin dhe koordinimin e aktiviteteve të anëtarëve të Asociacionit në fushat e investimit, zhvillimin ekonomik të komunave, përmirësimin e bazës ligjore, mbështetjen e bizneseve, kulturën, edukimin, shkencën, shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale dhe

shërbimet sociale, zgjidhjen e konflikteve, përmirësimin e shërbimeve për qytetarë dhe të tilla. Gjithashtu, shtyrja e masës ndëshkuese për regjistrimin pasues të lindjeve/vdekjeve, të cilat në gjendje normale penalizohen me gjobë komunale, u rendit në kërkesat e drejtorëve.

Sa i përket faktit nëse ata ishin të kënaqur apo jo me këtë bashkëpunim, shumica dërrmuese e drejtorëve komunalë (45%) ishin shumë të kënaqur ose disi të kënaqur (37%) me këtë bashkëpunim. Bazuar në këto rezultate, sipas drejtorëve komunal, mund të konkludohet se AKK ka adresuar kërkesat e komunave në nivel qendror, në kohë të duhur dhe me sukses.




Figura 12. Vlerësimi i bashkëpunimit me Asociacionin e Komunave të Kosovës, që nga përhapja e pandemisë COVID-19 në komuna

1.1.4. Nevojat emergjente të drejtorive për menaxhimin dhe tejkalimin e situatës së shkaktuar nga pandemia COVID-19

Një nga pjesët kryesore të këtij studimi ishte identifikimi i nevojave emergjente të drejtorive, në mënyrë që të menaxhohet dhe tejkalohej situata e krijuar nga pandemia COVID-19. Në këtë rast, rezultatet e hulumtimit tregojnë se anëtarët e drejtorive të ndryshme të komunave kishin nevoja emergjente të përbashkëta, në aspektin e tejkalimit të pasojave. Bazuar në këto rezultate, drejtorët komunal kanë përmendur disa nga nevojat urgjente të drejtorive të tyre.

Çka është identifikuar në përgjigjet e të gjithë drejtorëve komunal është nevoja për një studim të fizibilitetit për të vlerësuar dëmet ekonomike në nivel lokal. Përmes këtij studimi mund të krijohen masat mbështetëse për rimëkëmbjen ekonomike. Për më tepër, ata deklaruan se kjo rimëkëmbje duhet të bëhet përmes krijimit të një fondi specifik emergjent për menaxhimin e situatës së shkaktuar nga pandemia COVID-19 për secilën komunë të Kosovës.

Poashtu, drejtorët komunal përfshinë rishikimin e buxhetit, ri-alokimin dhe transferimin e tij si një nevojë emergjente. Duke konsideruar se ata kanë hasur probleme në menaxhimin e buxhetit komunal gjatë pandemisë, nevojitet ndihmë, rekomandime dhe qartësime për këtë çështje. Për më tepër, dhe jo më pak e rëndësishme, theksohet nevoja për ndryshimin e ligjit të prokurimit për situata emergjente.

Në anën tjetër, shërbimet online kanë hasur shumë vështirësi gjatë kohës së pandemisë. Shumica e drejtorëve komunal janë munduar të krijojnë mundësi për shërbime online më efikase, në rast të valës së dytë të pandemisë.

Kur u pyetën se çfarë masa tjera mund të ndërmerren nga palë të tjera, si Organizata Donatore, Institucione të Huadhënies, Asociacione të ndryshme, drejtorët komunal thanë se ofrimi i masave mbrojtëse, fondeve dhe subvencioneve mbështetëse për biznese të ndryshme, do të ndihmonin në menaxhimin dhe tejkalimin e kësaj situatë nëpër komuna.

Sidoqoftë, rezultatet treguan se kishte dallime në nevojat emergjente varësisht nga drejtoria, përpos emergjencave të përgjithshme që kishin të gjitha drejtoritë. Pjesët në vazhdim prezantojnë nevojat emergjente të ndara sipas drejtorive.

Drejtoria e Buxhetit dhe Financave

Sa i përket drejtorive të Buxhetit dhe Financave, përveç kërkesave të përgjithshme të shprehura në paragrafet më lart, ata adresuan edhe disa nevojat të tjera emergjente, specifike për sektorët e drejtorive të tyre. Asistenca financiare, përfshirë paket për rimëkëmbje ekonomike për bizneset, konsiderohet si nevojat kryesore emergjente për këtë kategori. Sipas tyre, pasi që të ardhurat nga tatimi në prone janë të ardhurat kryesore komunale, kjo drejtori do të ketë shumë vështirësi në realizimin e planifikimit buxhetor dhe implementimit të projekteve.

Të tjera nevojat emergjente të përmendura nga kjo drejtori ishin:

- Ndryshimi i Ligjit për Prokurim Publik,
- Ndryshimi i ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, dhe
- Implementimi i planit operacional të pakos emergjente fiskale.

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka listuar një numër të madh të nevojave emergjente. Sipas tyre, gjatë periudhës së përballjes me pandemisë, ka pasur një mungesë të madhe të stafit mjekësor, që në kushte normale do të duhej të ishte në proporcion me popullatën e komunës. Poashtu, nevojat për pajisje mjekësore u përmend, specifikisht në departamentet e emergjencës, laboratorëve dhe radiologjisë, mungesa e të cilave ka penguar punën e këtij sektori gjatë pandemisë.

Të tjera nevojat emergjente të përmendura nga kjo drejtori ishin:

- Rritja e numrit të inspektorëve shëndetësor,
- Ofrimi i ushqimit dhe pakove higjienike për familjet në nevojë, dhe
- Ofrimi i ambulancave për transportimin e rasteve me COVID-19 dhe një autobus për transportimin e pacientëve me hemodializë.

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik

Sa i përket Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, drejtorët listuan si emergjencë mbështetjen financiare për sektorë të ndryshëm të bizneseve të ndikuara nga pandemia. Sipas tyre, definimi i një plani për rimëkëmbje ekonomike dhe aktivitete ekonomike, përfaqëson një nevojë urgjente, përmes së cilës problemet tjera mund të adresohen. Kthimi i punëtorëve në vendet e punës, mbështetja e fermerëve përmes pakove financiare dhe heqja e taksës në sektorët e shërbimeve të hotelierisë dhe turizmit, mund të ndihmojnë në menaxhimin e nevojave emergjente të kësaj drejtorie.

“Pakoja emergjente e ndarë nga qeveria si mjet ndihmues në menaxhimin dhe tejkalimin e pasojave të shkaktuara nga pandemia COVID-19, ka arritur të plotësojë disa nevoja; sidoqoftë, ka lënë nevoja të tjera esenciale të pa përmbushura. Të ardhurat kanë zbritur për 50% në krahasim me vitin e kaluar; mirëpo, ne qëndrojmë optimist se do të ngrisim të ardhurat me anë të taksave mbi prone. Sidoqoftë, unë besoj se qeveria duhet të krijojë një buxhet të dedikuar për emergjenca, në rast të valës së dytë të COVID-19.” – Drejtor i Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Shtimes/Shtimlje

Të tjera nevoja emergjente të përmendura nga kjo drejtori janë:

- Hapja e thirrjes për grante dhe subvencione, sepse dihet se fermerët kanë përfunduar me kohë aktivitetet e tyre në fushë,
- Alokimi i 50% të mbetur të fondeve nga buxheti i konsoliduar i Kosovës për implementimin e projekteve komunale, dhe
- Shitja e produkteve të fermave.

Drejtoria e Arsimit

Drejtoria e arsimit ka pësuar një ndër ndryshimet më të mëdha gjatë pandemisë, me anë të realizimit të mësimin online. Kjo ka çuar në identifikimin e mungesës së mjeteve teknologjike në shkolla, si një nevojë emergjente. Kjo ka qenë shkak që një numër i madh i nxënësve të mos kenë qasje në edukim, sidomos nxënësit nga zonat rurale të komunave. Me avansimin e pajisjeve teknologjike në shkolla, shfaqet nevoja për trajnime në përdorimin e teknologjisë informative. Sipas drejtorëve, mungesa e njohurisë në këtë fushë, shpesh vjen si rezultat i moshës së lartë mesatare të mësuesve.

Të tjera nevoja emergjente të përmendura nga kjo drejtori janë:

- Dezinfektimi i objekteve shkollore dhe qerdheve;
- Analiza e procesit të mësimin në distance.

Drejtoria e Bujqësisë

Rritja e investimeve në bujqësi, sidomos subvencionimi i fermerëve për të tejkaluar dëmet e shkaktuara qoftë nga pandemia apo nga fatkeqësitë natyrore, është identifikuar si nevoja kryesore emergjente e kësaj drejtorie.

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Për më tepër, bazuar në rezultatet e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, nevojat emergjente përfshijnë: mbështetjen e sektorit të kulturës gjatë riaktivizimit, mbështetje e menjëhershme e klubeve duke i subvencionuar ato nga pakoja emergjente e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), mbështetje e rinisë në komuna për ndërmarjen e aktiviteteve lidhur me shmangien e pasojave të shkaktuara nga pandemia për të rinjtë, përfshirë menaxhimin e stresit, gjendjen emocionale, etc.

Drejtori e Administratës

Duke marrë parasysh se Administrata ishte një nga drejtoritë që ka pasur më së shumti kontakt me klientë/palë, ata kanë përmendur krijimin e shërbimeve online si nevojë emergjente.

“Kapacitetet tona kanë filluar të shterren dhe ne kemi mbetur të paaftë për të mbuluar shpenzimet e mëdha. Duke u nisur nga fakti se drejtorja jonë është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve dhe adresimin e kërkesave, ne jemi të paaftë kundrejt kërkesave të mëdha që na vijnë në baza ditore. Për më tepër, ne jemi pak të furnizuar me maska, dorëza dhe dezinfektues, produkte të cilat janë esenciale për punën tonë.” – Drejtorja e Administratës në Komunën e Fushë Kosovës/Kosovo Polje

Drejtorja e Shërbimeve Publike

Për fund, udhëzime të sakta për përgatitjet dhe mënyrat e dezinfektimit të hapësirave publike, rrugëve dhe zonave urbane, trajnimi i stafit menaxhues dhe punëtorëve të shërbimeve publike dhe emergjente përmes trajnimeve për situata emergjente, u listuan si nevoja emergjente të kësaj drejtorie.

“Qeveria e re ka bërë shumë ndryshime dhe ka shfuqizuar shumë vendime. Kështu, shpenzimet që kemi bërë në vlerë prej 30.000€ për pajisje ushqimore, higjienike dhe mjekësore nuk do të rimbursohen, sipas vendimeve të reja të qeverisë së re. Si pasojë, kërkesat e qytetarëve nuk do të adresohen.” – Drejtor i Shërbimeve Publike në Komunën e Istogut/Istok

4.3. Zhvillimi i kapaciteteve/nevojat për trajnime për përfaqësuesit komunal

Në fund të studimit, drejtorët komunal u pyetën për nevojën për trajnime të zyrtarëve në departamentet e tyre. Shumica e tyre (70%) deklaruan se një numër i ndjeshëm i zyrtarëve të tyre kanë nevojë për zhvillim të kapaciteteve/trajnime. Gjatë përgjigjes, ata kishin mundësi të specifikonin fushat në të cilat zyrtarët kanë nevojë për zhvillim të kapaciteteve/trajnime. Ajo që dallohet, mes të tjerash, ishte nevoja për të ndarë eksperiencën në menaxhimin e situatave emergjente, si pandemia COVID-19. Sipas drejtorëve, vështirësitë në menaxhimin e situatave dhe përvojat, qoftë pozitive apo negative, mund të ndahen mes tyre. Tema të tjera përfshinin trajnimet në planifikimin dhe hartimin e buxhetit në situata emergjente, trajnime të shërbimeve online, të prokurimit, dhe për mbrojtjen e bimëve (pemishte, prodhimtari, lavanderi) nga pesticidet dhe sëmundjet e ndryshme.




Figura 13. Përqindja e përfaqësuesve të komunave që kanë nevojë për ngritje të kapaciteteve / trajnime

Për më tepër, nga numri i drejtorëve që deklaruan se ka nevojë për ngritje / aftësim të kapaciteteve për zyrtarët e drejtorisë së tyre, shumica e tyre (78%) preferuan që këto trajnime të zhvillohen me pjesëmarrje fizike. Sipas tyre, përmes pjesëmarrjes fizike, mundësitë e shkëmbimit të përvojave ndërmjet drejtorëve do të ishin më të mëdha.




Figura 14. Mënyra e preferuar e pjesëmarrjes në trajnime

1.2. Ndikimi i pandemisë COVID-19 në të ardhurat vetanake komunale

Përtej tragjedisë shëndetësore dhe njerëzore të COVID-19, tashmë dihet se kjo pandemi nxiti krizën më serioze ekonomike të shekullit. Ndikimi regional dhe lokal i krizës COVID-19 është tejet heterogjen, me një dimension të fuqishëm territorial dhe pasoja signifikante për menaxhimin e krizës dhe përgjigjet e politikave:

- **Ndikimi shëndetësor/shoqëror:** disa rajone, specifikisht ato më të cënueshme, si zonat urbane të privuara, janë ballafaquar me numër më të madh të rasteve dhe shkallë të vdekshmërisë, sesa të tjerat. Popullata më të cënueshme, poashtu, janë prekur më shumë.
- **Ndikimi ekonomik:** ekspozimi ekonomik rajonal ndaj krizës ndryshon bazuar në ekspozimin e një zone ndaj zinxhirëve të vlerës globale dhe specializimin në sektorë të veçantë si turizmi, të paktën në fazat fillestare.
- **Ndikimi financiar:** kriza ka rezultuar në rritjen e shpenzimeve dhe zvogëlimin e të ardhurave për qeveritë nën-nacionale, dhe megjithëse ndikimi i saj në financat nën-nacionale nuk është uniform, pritet të jetë afatgjatë.¹²

Shumica e komunave marrin të ardhurat e tyre nga një kombinim i burimeve, të tilla si tatami në pronë, taksat për licencën për të ushtruar veprimtari biznesi, taksat për leje profesionale dhe shërbimet, taksat për automjetet motorike, tarifat administrative komunale, taksat për ndërtimin dhe lejet e prishjes së ndërtesave dhe strukturat e tjera, taksat për lëshimin e certifikatave dhe

¹² Përgjigjet e politikave të OECD për Coronavirus (COVID-19). Ndikimi territorial i COVID-19: Menaxhimi i krizës në të gjitha nivelet e qeverisjes (2020). Marrë më: 5 Korrik, 2020, nga: <http://www.oecd.org/coronavirus/policy-responses/the-territorial-impact-of-covid-19-managing-the-crisis-across-levels-of-government-d3e314e1/>

dokumenteve zyrtare, tarifat rregullatore për zhvillimin ose mirëmbajtjen e infrastrukturës, gjobat në trafik, gjobat për shkëlje të rregullave komunale, të ardhurat nga qiraja, bashkë-pagesa për arsimin dhe shëndetin, dhe secila prej këtyre burimeve të të ardhurave është ndikuar ndryshe.

Bazuar në rezultatet e studimit, drejtorët komunalë deklaruan se vendimet e qeverisë për të menaxhuar situatën e krijuar nga pandemia COVID-19, siç janë kufizimet në lëvizjet e qytetarëve, pezullimi i veprimtarive të biznesit, përjashtimi i bizneseve nga taksat, mungesa e gjobave në trafik, ndikuan në rënien e ndjeshme të të ardhurave vetanake të komunës.

Sipas raporteve komunale në Ministrinë e Financave dhe Transfereve, në Mars dhe Prill 2020, të gjitha komunat në Kosovë kanë mbledhur të ardhura me vlerë rreth 5.8 milion €, ose rreth 9.3 milion € më pak në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kriza gjithashtu ka shpejtuar rënien e të ardhurave të qeverisë, me 11 përqind në krahasim me vitin e kaluar, duke lënë hapësirë të kufizuar fiskale për të financuar këto programme. Prandaj qeveria do të ketë nevojë për mbështetje të jashtme për të siguruar ndihmë financiare të nevojshme për familjet e varfëra dhe të cënuara gjatë muajve të ardhshëm për t'iu përgjigjur pasojave të drejtpërdrejta ekonomike të pandemisë dhe masave të kontrollit.¹³

Efektet më të mëdha do të jenë në rënien e të ardhurave nga tatimi në pronë. Ministria e Financave dhe Transfereve ka hequr si detyrim pagimin e taksës së pasurisë si kusht për regjistrimin e automjetit në komunë. Për periudhën nga mesi i Marsit deri në Qershor 2020, automjetet mund të regjistrohen vetëm me pagesën e polisës së sigurimeve. Taksimi mbi pronën paraqet hyrjen kryesore për shumicën e komunave. Për më tepër, të ardhurat e tjera të krijuara nga komuna do të bien ndjeshëm, pasi të gjithë sektorët nga të cilët mbledhen të ardhurat e pushtetit lokal preken nga masat e marra për të parandaluar përhapjen e pandemisë COVID-19.¹⁴

Për më tepër, shpenzimet kryesore dhe masat tatimore përfshijnë: (i) alokimin prej 6 milion € për ministrinë e shëndetësisë; (ii) shtyrjet për të ardhurat e korporatave dhe taksat mbi të ardhurat personale, dhe TVSH-në; (iii) avancimin e pagesave për skemat e ndihmës sociale me një shumë shtesë prej një muaji (nga një muaj në dy muaj) për të mbështetur familjet në nevojë; (iv) heqja e TVSH-së në importet e grurit dhe miellit; (v) shtyrja e pagesave të shërbimeve publike deri në fund të Prillit. Për më tepër, pakoja fiskale në vlerë prej 180 milion € (2.5 përqind e PBB-së) është miratuar nga qeveria dhe 48 përqind e kësaj pakoje është ekzekutuar që nga 30 qershori. Ministria e Financave i është drejtuar Institucioneve Financiare Ndërkombëtare (IFN) (p.sh. Fondi Monetar Ndërkombëtar - FMN, Banka Botërore - BB, Bashkimi Evropian - BE dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim - BERZH) dhe donatorë të tjerë dypalësh për mbështetje financiare. Ministria e Financave ka filluar të bëjë pagesa për punëtorët ashtu siç ishte planifikuar nën pakon fiskale, ku deri më tani janë paguar 82 milion €. Banka Qendrore e Kosovës (BQK) së bashku me Shoqatën e Bankave të Kosovës vendosën të pezullojnë pagesën e kësteve të kredisë për bizneset dhe individët duke filluar nga 16 Marsi deri më 30 Prill dhe më pas ta zgjasin atë në tre muaj deri në mes të Qershorit, duke e zgjatur

¹³ Projekti COVID-19 i Emergjencës së Bankës Botërore të Kosovës (2020) Marrë më: 5 Korrik, 2020, nga: <http://documents1.worldbank.org/curated/en/688551588682793534/pdf/Project-Information-Documents-KOSOVO-EMERGENCY-COVID-19-PROJECT-P173819.pdf>

¹⁴ INSTITUTI GAP. Ndikimi i pandemisë COVID-19 në qeverinë lokale (2020). Marrë më: 3 Korrik, 2020, nga: https://ëëë.institutigap.org/documents/23503_Ndikimi%20i%20pandemis%C3%AB%20COVID-19%20n%C3%AB%20pushtetin%20lokal.pdf?fbclid=IêAR1dmr4MX0cKS0q0bVJPhZ41oxj29ë2l0ejhrhMzUNj0iXYdtn5NiqF30

përfundimisht deri në mes të Gushtit. BQK-ja do të zbatojë kontrollin rregullator mbi provizionet e kredisë dhe kërkesat e kapitalit për kreditë e riprogramuara.¹⁵

5. PËRFUNDIMET

Rezultatet e këtij studimi, përveç identifikimit të nevojave emergjente dhe ndikimit socio-ekonomik të COVID-19 në qeverisjen vendore, do të japin një udhëzim për hartimin e programeve, aktiviteteve ose formave të ndërhyrjes për të mbështetur komunat e Kosovës në përpjekjet e tyre kundër pandemisë COVID-19, si dhe pasojat e shkaktuara nga kjo e fundit. Ky udhëzues do të përdoret nga të gjitha institucionet përkatëse të nivelit lokal dhe qendror, si dhe nga palët e tjera të interesit.

Si i tillë, pjesa vijuese paraqet përfundime të nxjerra nga rezultatet e studimit për një udhëzim më të mirë dhe më efikas drejt mbështetjes së komunave për të kapërcyer situatën e krijuar nga COVID-19.

Vështirësitë me të cilat u përballuan Komunat/Drejtoritë që nga përhapja e pandemisë COVID-19

Në përgjithësi, vështirësitë që kanë hasur komunat e ndryshme gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 janë pothuajse të njëjta. Vendimet e qeverisë, në lidhje me kufizimet në lëvizjen e qytetarëve, ndërprerjen e punës së bizneseve të ndryshme dhe pezullimin e projekteve kapitale të parashikuara kanë ndikuar ndjeshëm në uljen e të ardhurave komunale. Kështu, buxheti i kufizuar komunal e ka bërë shumë të vështirë menaxhimin e kësaj situate.

Në fillim, e gjithë periudha e pandemisë ishte një sfidë e paparë për këto komuna. Përballja me një virus të panjohur, mungesa e informacionit në lidhje me COVID-19 në fillim të përhapjes së tij ka shkaktuar shumë vështirësi në komuna. Nga ana tjetër, rezultatet tregojnë se më shumë se gjysma e përfaqësuesve të komunave (57%) i konsideruan komunat e tyre disi të përgatitura në trajtimin e situatës pandemike.

Pavarësisht nga vështirësitë e lartpërmendura, rezultatet tregojnë se vështirësi të tjera që hasen nga komunat përfshijnë numrin e vogël të stafit mjekësor në Qendrat Mjekësore Familjare, mungesën e pajisjeve mbrojtëse, siç janë maskat, dorezat dhe dezinfektuesit e ndryshëm, si dhe rritja familjeve në nevojë. Një sfidë e veçantë gjatë kësaj periudhe ishte edhe mësimi nga distanca, marrë parasysh mungesën e përvojës me një sistem të tillë si dhe pajisjeve teknologjike për ndjekjen e mësimit online.

Masat e marra nga Komunat/Drejtoritë që nga përhapja e pandemisë COVID-19

Në përgjithësi, ka një numër masash të ndërmarra nga komunat, konkretisht drejtoritë, që janë të ngjashme me njëra-tjetrën. Fillimisht, me përhapjen e pandemisë, të gjithë përfaqësuesit e komunave kishin marrë vendimin për dezinfektimin e objekteve të sektorëve që ata përfaqësojnë. Më tej, me vendimet e qeverisë për kufizimet e lëvizjes, një numër i madh i stafit komunal janë liruar nga puna, në mënyrë që të vazhdojnë të punojnë nga shtëpia ose të mos punojnë fare (në raste të moshës së shtyer, për shkak të mbrojtjes shëndetësore).

Sa i përket masave të tjera të ndërmarra nga komunat, rezultatet nxjerrin një numër aktiviteteve të bazuara në drejtori. Ndihma financiare, përgatitja e pakove emergjente, shpërndarja e pakove të

¹⁵ Fondi Monetar Ndërkombëtar. Përgjigjet e politikave ndaj COVID-19. Marrë më: 3 Korrik, 2020, nga: <https://www.imf.org/en/Topics/imf-and-covid19/Policy-Responses-to-COVID-19>

ushqimit dhe higjenës për familjet në nevojë, mbikëqyrja e mësimit në internet, pajisja e fermerëve me Certifikata të Fermerëve (NIF), për kryerjen e aktiviteteve bujqësore dhe ndihmë me pajisje mjekësore në sektorin bujqësor, janë masat kryesore të përmendura nga drejtoritë pjesëmarrëse.

Bashkëpunimi me institucionet e nivelit qendror dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës që nga përhapja e pandemisë COVID-19

Ajo që ndihmon në administrimin e situatave të tilla është komunikimi i ndërsjellë midis nivelit lokal dhe qendror. Kërkesat drejtuar institucioneve të nivelit qendror dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës, varen nga ministria, ku drejtorët drejtuan ankesat, rekomandimet dhe sqarimet e tyre.

Sipas rezultateve, shumica e përfaqësuesve të komunave (71%) kanë bashkëpunuar gjatë kësaj kohe me institucionet e nivelit qendror. Këto të fundit (55%) deklarojnë se janë "Shumë / deri diku të kënaqur" me këtë bashkëpunim.

AKK, si gjithmonë, ka luajtur rolin e një personi juridik që përfaqëson interesat e përgjithshme të anëtarëve të tij - autoritetet lokale. Një numër i konsiderueshëm i përfaqësuesve komunal (57%) kanë bashkëpunuar me AKK-në gjatë periudhës së pandemisë, ku shumica e tyre (82%) kanë shprehur një nivel të lartë të kënaqësisë për këtë bashkëpunim. Përmes këtij bashkëpunimi, drejtorët kanë adresuar kërkesat e tyre drejt vendimeve dhe menaxhimit të situatës, ndërsa AKK i ka informuar ata rreth vendimeve të qeverisë, duke dhënë sqarime shtesë në rast nevojë.

Nevojat e Eemergjente të Komunave/Drejtorive në menaxhimin dhe tejkalimin e situatës së shkaktuar nga pandemia e COVID-19

Në fund, pas identifikimit të nevojave emergjente për të menaxhuar dhe kapërcyer si duhet situatën e krijuar nga pandemia COVID-19, rezultatet tregojnë se ekzistojnë një numër nevojash që ndahen midis drejtorive. Në këtë drejtim, një numër i madh i përfaqësuesve të komunave mendojnë se një studim mbi dëmin ekonomik në komuna do të ndihmojë në menaxhimin e pasojave të pandemive. Kështu, ri-alokimi i buxhetit, mbështetja financiare dhe fondet janë identifikuar si nevojë urgjente për komunat në mënyrë që të menaxhojnë me sukses pasojat pandemike COVID-19.

Lidhur me nevojat emergjente bazuar në plotësim/ndryshim të ligjeve, përfaqësuesit e komunave e konsiderojnë ndryshimin përfundimtar të ligjeve të prokurimit në situata emergjente si një nevojë prioritare emergjente. Nga ana tjetër, në rast të një vale të dytë të pandemisë, përmirësimi i shërbimeve online duhet të merret në konsideratë, në mënyrë që të lehtësohen proceset e punës së përfaqësuesve të komunave.

Përveç kësaj, përfaqësuesit e komunave deklarojnë se nevoja të tjera emergjente siç janë masat parandaluese, shpërndarja e një fondi specifik emergjence, ndihma financiare për fermerët dhe punësimi sezonal për individët e papunësuar do të kishin një rëndësi të madhe për tejkalimin e situatës. Frika nga një valë e dytë e pandemisë ka bërë që këta përfaqësues komunal të rendisin furnizimin e pajisjeve mbrojtëse si nevojë emergjente.

Pavarësisht nga nevojat emergjente që drejtoritë e ndryshme kanë të përbashkëta, ekzistojnë nevoja specifike emergjente të ndara bazuar në drejtori, të cilat përfshijnë asistencën financiare, duke përfshirë pako të rimëkëmbjes ekonomike për bizneset, mungesën e personelit shëndetësor, përkufizimin e një plani për rimëkëmbjen ekonomike dhe aktivitetin ekonomik.

Si përfundim, për të menaxhuar situatën e krijuar nga pandemia COVID-19, që nga përhapja e saj në Mars 2020, institucionet përkatëse të nivelit lokal dhe qendror, si dhe palët e tjera të interes, duhet të marrin parasysh nevojat emergjente të listuara më lart nga tetë (8) drejtoritë më të prekura të komunave të Kosovës. Duke adresuar këto nevoja emergjente, përmes hartimit të programeve, aktiviteteve ose formave të ndërhyrjes, komunat e Kosovës do të mbështeten për të luftuar pandeminë COVID-19 dhe pasojat e shkaktuara nga kjo e fundit.